

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XIX, nr. 5700  
E martë, 12 shkurt 2019  
çmimi 0.40 €

## AShAK-u kundërshton idenë për ndryshimin e kufirit Kosovë - Serbi

FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

FLET PËR 'EPOKËN E RE', ALI AHMETI | FAQE 4-5



# MAQEDONISË I DUHET NJË PRESIDENT QË PRANOHET NGA TË GJITHË

Kryetari i Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI), Ali Ahmeti, ka thënë se përmbyllja e kontestit midis Shkupit dhe Athinës dhe nënshkrimi i protokollit për anëtarësim në NATO janë arritje të jashtëzakonshme. Ai ka theksuar se kontributi i BDI-së ka vulosur këto procese historike. Në

këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Ahmeti ka shprehur optimizëm se në këtë mandat do të fillojë bisedimet për anëtarësim, kurse në vitin 2025 vendi mund të hyjë në BE. Ai ka vlerësuar se BDI-ja është e përgatitur për zgjedhjet presidenciale të 21 prillit. Ahmeti ka

thënë se Maqedonisë Veriore i duhet një president i pranuar nga të gjithë. Ai ka pohuar se 2019-a është vit i vendimeve të mëdha në Ballkanin Perëndimor. Në këtë kontekst, Ahmeti ka thënë se Kosova dhe Serbia duhet ta arrijnë marrëveshjen për njohjen e ndërsjellë

## Liderët kërkojnë unitet për platformën e dialogut

Krerët institucionale dhe disa anëtarë të Delegacionit Shtetëror për Dialog të hënë kanë diskutuar për platformën e dialogut, duke ftuar gjithë spektrin politik ta mbështetë këtë platformë në Kuvend, në kohën kur presioni amerikan për heqjen e taksës është shtuar. Në të njëjtën ditë komandanti i FSK-së, Rahman Rama, ka njoftuar se Qeveria amerikane ka anuluar vizitën e gjeneralit amerikan të Gardës



Nacionale të Iowas, Timothy Orr, në Kosovë, në shenjë pakënaqësie me Qeverinë e Kosovës për mospezullimin e taksës ndaj produkteve serbe | FAQE 3



### MASH-T-i vendos t'i kompensojë orët e humbura të mësimit nga greva

FAQE 5

## AKTUALE

### SHKODRA E SHQIPËRISË DHE VERIU I KOSOVËS, PARALELE HISTORIKE

F. 11



Prof. Lisen BASHKURTI

### KLINIKA E ORTOPEDISË, PRIORITET I INVESTIMEVE NË SHSKUK

F. 8

## EKONOMI

### HARADINAJ: JEMI PËRCAKTUAR QË PRODHUESVE TË VENDIT T'U JAPIM MË SHUMË PËRKRAHJE

F. 9

### RRITET BASHKËPUNIMI NË SEKTORIN ENERGETIK NË MES TË KOSOVËS DHE MAQEDONISË

F. 9

## KULTURË

### KOSOVA SHËNJON VENDET E TRASHËGIMISË DHE ATO TURISTIKE

F. 13

### DRITË DIELLORE, RRUGËTIM SHEKULLOR DHE JETËSOR PËR LIRI

F. 12

Shkelqim MILLAKU

## SPORT

### GJYQARËT E KOSOVËS, PJESË E KONVENTËS SË GJYQARËVE TË UEFA-S

F. 15

### PSG-ja E 'PLAGOSUR' PËRBALLË UNITEDIT, ROMA PRET PORTON

F. 15

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegijbiznesi.com  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Pruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë, Vite  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

## Kuvendi i Shqipërisë i hap rrugën Maqedonisë për në NATO

TIRANË, 11 SHKURT - Komisioni i Ligjeve në Kuvendin e Shqipërisë ka miratuar unanimisht protokollin që i hap rrugën ratifikimit të vendimit për votën

pro për hyrjen e Maqedonisë së Veriut në NATO. Ky miratim i ndez dritën jeshile Kuvendit të Republikës pasnesër (e enjte), i cili pritet të ratifikojë, po ashtu unan-

imisht, për një kapitull të ri të shtetit fqinj. Në seancën e së enjtes në Parlamentin shqiptar pritet të jetë i pranishëm edhe kreu i Kuvendit të Maqedonisë,

Talat Xhaferi. Arritja e marrëveshjes në mes të Greqisë dhe Maqedonisë është konsideruar si një hap pozitiv, e cila i jep garanci paqes dhe prosperitetit në Ballkan.



# Nis heqja e mbishkrimeve me emrin Maqedoni

Nga ndërtesa e ekzekutivit është larguar mbishkrimi Qeveria e Republikës së Maqedonisë për t'u zëvendësuar me emrin Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Mbishkrimi do të jetë edhe në gjuhën shqipe

Shkup, 11 shkurt - Maqedonia e Veriut dhe Greqia nga e hëna kanë nisur zbatimin e Marrëveshjes së Prespës. Tabela e parë me emrin e ri Republika e Maqedonisë së Veriut ka mbërritur në vendkalimin kufitar Bogorodica me Greqinë. Edhe nga ndërtesa e ekzekutivit është larguar mbishkrimi Qeveria e Republikës së Maqedonisë për t'u zëvendësuar me emrin Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Mbishkrimi do të jetë edhe në gjuhën shqipe. Veç kësaj, para Qeverisë tani do të qëndrojë edhe flamuri i NATO-s.

Nga Qeveria ende nuk japin detaje se në cilat institucione të tjera do të ndërrohen tabelat, të cilat, po ashtu, do të jenë në dy gjuhë. Jozyrtarisht, siç bëhet me dije, Kuvendi, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Mbrojtjes pritet të jenë të parat që do t'i zbatojnë detyrimet nga Marrëveshja e Prespës. Sipas paralajmërimeve nga Qeveria, sot (e martë), ndryshimet kushtetuese do të shpallen në Gazetën Zyrtare që edhe zyrtarisht do të hyjë në fuqi emri i ri i shtetit, Republika e Maqedonisë së Veriut.

Në bazë të këtij dokumenti, me të cilët u zgjidh kontesti 27-vjeçar i emrit, brenda një jave të gjitha institucionet shtetërore, përfaqësitë diplomatike dhe vendkalimet kufitare duhet të vendosin tabela të reja në tri gjuhë, maqedonisht, shqip dhe anglisht. Ndërkohë dy vendet kanë shkëmbyer notat për ratifikimin e marrëveshjes, pastaj Maqedonia e Veriut dhe Greqia do t'i njoftojnë organizatat ndërkombëtare për ndërrimin e emrit. "Republika e Maqedonisë së Veriut dhe Greqia do t'ia dërgojnë një letër të përbashkët sekretarit të përgjithshëm të OKB-së, me të cilën do ta informojnë kreun e saj, Antonio Guterres, me datën e hyrjes në fuqi të marrëveshjes, me çka i jepet fund kontestit prej disa dekadave të emrit mes dy vendeve", thuhet në një njoftim me shkrim të Ministrisë së Jashtme.

Emri i ri do të kërkohet që të përdoret edhe nga më shumë se 130 shtete të cilat e kanë njohur shtetin me emrin e deritanishëm, Republika e Maqedonisë. Qeveria ka formuar edhe një grup ekspertësh që duhet të hartojë një



plan veprimi për zbatimin e detyrimeve nga marrëveshja, por procesi do të marrë kohë.

Në bazë të marrëveshjes, ndërrimi i dokumenteve të identifikimit, i letërnjoftimeve dhe pasaportave, do të zgjasë pesë vjet nga dita e hyrjes në fuqi të marrëveshjes.

Njohësit e çështjeve ndërkombëtare nuk presin të ketë probleme në zbatimin e dokumentit, në veçanti sa i përket anëtarësim-it në NATO. Vështirësi, sipas Llazar Llazarovit, mund të ketë në procesin e integritit evropian, në pjesën e zbatimit të ligjeve.

"Ne deklarativisht i zbatojmë reformat, miratojmë edhe ligjet e gjithçka tjetër, por në praktikë këto shumë vështirë zbatohen. Ka

shumë punë për të bërë, janë kapituj të tërë për të cilat duhet në detaje të bisedohet dhe të harmonizohen, por edhe të zbatohen, si në pjesën e gjyqësisë, prokurorisë apo sundimin e ligjit, lirinë e shprehjes, të drejtat e njeriut, administratë e kështu me radhë", thotë Llazarov.

Sa i përket palës greke, ai çështjen e NATO-s e konsideron të mbyllur, ndërsa lidhur me integritimin në BE dhe kërcënimet e opozitës greke, se do të bllokojë Maqedoninë e Veriut në çështjen e kapitujve, Llazarov thotë se tentime mund të ketë, por ato, sipas tij, më shumë kanë të bëjnë me fitimin e pikëve politike nga opozita sesa që mund të jenë reale.

"Lideri i opozitës greke, Kyriakos Mitsotakis, ka paralajmëruar se do ta pengojë këtë proces të NATO-s. Nuk besoj, pasi është çështje e kryer, por në çështjen e integritit evropian mund të bëjë probleme, se do të vendosë kushte në të gjithë 35 kapitujt për të cilat do të hapen bisedime. Por, edhe këtu nuk besoj se do t'ia arrijë qëllimit, i cili më tepër ka të bëjë me forcimin e pozitës së tij për të fituar në zgjedhje sesa për ta bllokuar Maqedoninë. Sikur edhe të fitojë në zgjedhje, ai nuk do të mund ta bllokojë procesin integruar, pasi është një çështje pas së cilës qëndrojnë fuqitë e mëdha si BE-ja, ShBA-ja dhe NATO-ja", thotë Llazarov, njohës i çështjeve ndërkombëtare.

## Kosova dhe Mali i Zi, konsultime politike për bashkëpunimin dypalësh

PRISHTINË, 11 SHKURT - Delegacioni i Ministrisë së Punëve të Jashtme i Republikës së Kosovës, nën udhëheqjen e drejtorit të përgjithshëm, Albert Prenkaj, dhe ai nga pala malazeze i udhëhequr nga Ivan Lekoviq, drejtor i përgjithshëm i bilaterales, kanë mbajtur një takim të rregullt pune për konsultime politike dypalëshe, ashtu siç edhe parashihet me marrëveshjen e përbashkët të dy ministrive respektive.

Takimi është zhvilluar në Podgoricë, ndërsa temat që janë trajtuar kanë përfshirë marrëdh-

ëniet bilaterale, bashkëpunimin ekonomik, vlerësimin e gjendjes në lëmin e raporteve kontraktuale ndërmjet dy vendeve, bashkëpunimin në kuadër të integritimeve në NATO dhe BE dhe bashkëpunimin multilateral dhe rajonal.

Gjatë këtij takimi të dy drejtuesit e delegacioneve kanë vlerësuar se marrëdhëniet bilaterale ndërmjet Kosovës dhe Malit të Zi janë shumë të mira dhe, që nga konsulta e kaluar, kanë shënuar progres, që mund të vërehet përmes kontakteve të

shumta e të rregullta, vizitave të drejtuesve më të lartë shtetërorë si dhe mbështetje reciproke.

Në të njëjtën takim është konfirmuar edhe gatishmëria dhe interesimi i ministrit të Jashtëm të Malit të Zi, Darmanoviq, për vizitë zyrtare në Prishtinë, gjatë gjysmës së parë të muajit mars. Nga pala e Kosovës në këtë takim kanë marrë pjesë edhe ambasadorët Valdet Sadiku, Ariana Zherka, Skender Durmishi, drejtori i Diplomacisë Ekonomike, Gyner Urea dhe zyrtari i lartë, Bekim Misini.



Kryeparlamentari Kadri Veseli ka pritur të hënën në takim liderët institucionalë dhe disa anëtarë të Delegacionit Shtetëror për Dialog

# Liderët kërkojnë unitet për platformën e dialogut



Press release (Official publication)

Krerët institucionalë dhe disa anëtarë të Delegacionit Shtetëror për Dialog të hënën kanë diskutuar për platformën e dialogut, duke ftuar gjithë spektrin politik ta mbështetë këtë platformë në Kuvend, në kohën kur presioni amerikan për heqjen e taksës është shtuar. Në të njëjtën ditë komandanti i FSK-së, Rrahman Rama, ka njoftuar se Qeveria amerikane ka anuluar vizitën e gjeneralit amerikan të Gardës Nacionale të Iowas, Timothy Orr, në Kosovë, në shenjë pakënaqësie me Qeverinë e Kosovës, për mospezullimin e taksës ndaj produkteve serbe

është folur rreth kërkesës së ShBA-së për pezullimin e taksës. Bisedimet për normalizimin e marrëdhënieve midis Kosovës dhe Serbisë janë ndërprerë prejse Kosova u ka vënë taksë 100 për qind prodhimeve të Serbisë dhe Bosnjë e Hercegovinës, në nëntorin e kaluar.

Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, ka thënë se bisedimet nuk do të vazhdojnë pa u hequr taksat. Nga ana tjetër, Qeveria e Kosovës vazhdon të insistojë në mosheqjen e taksës, pavarësisht prej kërkesës së vazhdueshme të ShBA-së dhe të BE-së për këtë çështje.

Kryeministri Ramush Haradinaj edhe gjatë ditës ka rikonfirmuar qëndrimin e tij se nuk do të hiqet taksat. "Ata që bëjnë ndërkamca me e bind Kosovën ta heqë taksën, nuk jam me ta. Taksat do të hiqet vetëm kur Serbia është e gatshme ta njohë Kosovën", ka thënë Haradinaj gjatë fjalimit të mbajtur para familjeve të dëshmorëve të Komunitetit të Deçanit.

Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Rrahman Rama, ka njoftuar të hënën presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi, përmes një letre, në të cilën bëhet me dije se Qeveria amerikane ka marrë vendim që ta anulojë vizitën e gjeneralit amerikan të

Gardës Nacionale të Iowas, Timothy Orr, në Kosovë, në shenjë pakënaqësie me vendimin e Qeverisë së Kosovës për vendosje të taksës në produktet e Serbisë dhe Bosnjë e Hercegovinës.

Në letërën e komandantit Rama, e cila është publikuar në medie, është thënë se zyrtarë amerikanë në Kosovë e kanë njoftuar atë se Uashingtoni është duke shqyrtuar edhe masa të tjera, përfshirë këtu pezullimin e programeve trajnuese dhe edukative për FSK-në.

Gjenerali Rama, në një përgjigje për 'Radio Evropa e Lirë', ka deklaruar se për anulimin e vizitës në Kosovë të gjeneralit amerikan Orr, përveç presidentit, e ka njoftuar edhe kryeministrin Ramush Haradinaj dhe ministrin e Mbrojtjes, Rrustem Berisha. "Realisht, nuk është një lajm i mirë. Definitivisht është anuluar vizita e gjeneralit në Kosovë. Orientimi ynë është i qartë dhe bashkëpunimi që e kemi pasur dhe që e kemi deri më tash. Pra, falë angazhimit të tyre dhe përkrahjes së tyre, ne jemi këtu ku jemi. Por, nuk besoj se do të vijmë deri në atë masë që këto aktivitete të anulohen. Është partner ynë strategjik. Besoj se këto janë vendime politike dhe si pasojë e taksës që

është ndaj Serbisë, është marrë ky vendim nga Qeveria e ShBA-së", ka thënë Rama.

Lidhur me paralajmërimin e mundësisë së anulimit të trajnimeve dhe vizitave ushtarake në ShBA, gjeneralletenant Rama ka thënë se shpreson se nuk do të arrihet deri në atë pikë. "Këto më shumë janë tash çështje politike, të cilat mua nuk më takon t'i komentoj. Paralajmërimet ka pasur dhe tash ne presim se çfarë do të ndodhë. Por, gjithmonë jemi me shpresën që nuk do të ndodhë dhe nuk do të arrijmë deri tek ajo situatë", është shprehur Rama.

Vizita e gjeneralit amerikan ishte paraparë të realizohet nga data 16 deri më 18 shkurt për ta shënuar 11-vjetorin e pavarësisë së Kosovës. Ditë më parë edhe Ambasada e Shteteve të Bashkuara ka bërë me dije se Shtetet e Bashkuara insistojnë se veprimet që minojnë dialogun dhe refuzimi për ta pezulluar taksën shkojnë kundër interesave të ShBA-së.

Ndërsa presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, të premten, pas kthimit nga vizita në ShBA, ka ftuar Qeverinë e Kosovës që ta dëgjojë këshillën e ShBA-së për ta pezulluar taksën dhe për t'i dhënë mundësi dialogut.

**EPOKA  
ERE**

**Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 11 SHKURT - Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Kadri Veseli, ka pritur të hënën në takim të përbashkët liderët institucionalë dhe disa anëtarë të Delegacionit Shtetëror për Dialog. Pas takimit, në të cilin kanë marrë pjesë presidenti Hashim Thaçi, kryeministri Ramush Haradinaj, bashkëkryesuesi i delegacionit, Fatmir Limaj, si dhe anëtarët e delegacionit, Enver Hoxhaj dhe Visar Ymeri, është thënë se i gjithë spektri politik duhet të bëhet bashkë në mbështetje të platformës për dialog, e cila së shpejti do të miratohet në

Kuvend. "Në këtë takim është diskutuar për procesin e fazës finale të dialogut, me theks të veçantë për Platformën e Dialogut, e cila pritet të miratohet së shpejti në Kuvendin e Kosovës. Pjesëmarrësit në takim u pajtuan që të gjithë përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës nga pozita dhe opozita duhet të bëhen bashkë në mbështetje të platformës së dialogut, ndërkaq u theksua se uniteti i skenës politike të Kosovës e forcon pozicionin ndërkombëtar të Kosovës në procesin e dialogut", është thënë në njoftimin për medie të kryeparlamentarit Kadri Veseli. Nuk është bërë me dije për publikun nëse në këtë takim

Flet për "Epokën e re", Ali Ahmeti

# Maqedonisë i duhet një presid

Kryetari i Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI), Ali Ahmeti, ka thënë se përmbyllja e kontestit midis Shkupit dhe Athinës dhe nënshkrimi i protokollit për anëtarësim në NATO janë arritje të jashtëzakonshme. Ai ka theksuar se kontributi i BDI-së ka vulosur këto procese historike. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Ahmeti ka shprehur optimizëm se në këtë mandat do të fillojnë bisedimet për anëtarësim, kurse në vitin 2025 vendi mund të hyjë në BE. Ai ka vlerësuar se BDI-ja është e përgatitur për zgjedhjet presidenciale të 21 prillit. Ahmeti ka thënë se Maqedonisë Veriore i duhet një president i pranuar nga të gjithë. Ai ka pohuar se 2019-a është vit i vendimeve të mëdha në Ballkanin Perëndimor. Në këtë kontekst, Ahmeti ka thënë se Kosova dhe Serbia duhet ta arrijnë marrëveshjen për njohjen e ndërsjellë



**EPOKA E RE** Shqipe HETEMI

**PRISHTINË, 11 SHKURT** - Kryetari i Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI), Ali Ahmeti, ka thënë të hënë se 2019-a është vit i vendimeve të mëdha dhe transformimit të Ballkanit Perëndimor. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka deklaruar se Kosova dhe Serbia duhet ta arrijnë marrëveshjen përfundimtare. "Viti 2019 me sa duket është vit i vendimeve të mëdha dhe transformimit të tërësishëm të Evropës Juglindore, nga një vatër e pasigurisë dhe krizës, në një rrëfim suksesi për kontinentin tonë. Kosova dhe Serbia medoemos duhet ta arrijnë njohjen e ndërsjellë dhe ta vijëzjnë kufirin shtetëror midis dy vendeve. Institucionet e Kosovës e kanë legjitimitetin e plotë për t'i zhvilluar këto bisedime dhe për të arritur kompromis me mbështetjen e plotë të Bashkimit Evropian dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës", ka theksuar ai.

Ahmeti ka thënë se përmbyllja e kontestit midis Shkupit dhe Athinës dhe nënshkrimi i protokollit për anëtarësim në NATO janë arritje të jashtëzakonshme dhe, sipas tij, kontributi i BDI-së ka vulosur këto procese historike. "Përmbyllja e kontestit gati tri dekada midis Shkupit dhe Athinës, por edhe arritja e marrëveshjes së fqinjësisë së mirë midis Sofjes dhe Athinës, rrumbullakimi i marrëveshjes paqësore të Ohrit dhe arritja e barazisë gjuhësore, firmosja e protokollit për anëtarësim në

NATO si dhe data për fillim të negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian, janë arritje të jashtëzakonshme të përbashkëta, ku ne si pjesëmarrës të drejtpërdrejtë në këto procese, jo vetëm sot, por edhe në gati dy dekadat e kaluara, kemi dhënë kontribut dhe vulën tonë mbi këto procese. Integrimi euroatlantik dhe barazia gjuhësore kanë qenë kryefjalë e veprimit tonë politik bashkë me zbatimin e tërësishëm të Marrëveshjes së Ohrit dhe ne sot ia arritëm qëllimit", ka deklaruar Ahmeti, duke shprehur optimizëm se në këtë mandat do të fillojnë bisedimet për anëtarësim, kurse në vitin 2025 vendi mund të hyjë në BE. Ai ka vlerësuar se BDI-ja është e përgatitur për zgjedhjet presidenciale të 21 prillit dhe, sipas Ahmetit, Maqedonisë Veriore i duhet një president i pranuar nga të gjithë. "Jemi të gatshëm të dalim edhe vetë me kandidat, por edhe me një kandidat të dakorduar paraprakisht dhe të pranueshëm", ka theksuar ai.

**"Epoka e re":** Z. Ahmeti, Maqedonia Veriore tashmë ka nënshkruar protokollin për anëtarësim në NATO. Si e vlerësoni këtë proces dhe cili ka qenë kontributi i partive shqiptare, sidomos i BDI-së?

Ahmeti: Përmbyllja e kontestit gati tri dekada midis Shkupit dhe Athinës, por edhe arritja e marrëveshjes së fqinjësisë së mirë midis Sofjes dhe Athinës, rrumbullakimi i marrëveshjes paqësore të Ohrit dhe arritja e barazisë gjuhësore, firmosja e protokollit për anëtarësim në NATO si dhe data për fillim të

negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian, janë arritje të jashtëzakonshme të përbashkëta ku ne si pjesëmarrës të drejtpërdrejtë në këto procese, jo vetëm sot, por edhe në gati dy dekadat e kaluara, kemi dhënë kontribut dhe vulën tonë mbi këto procese. Integrimi euroatlantik dhe barazia gjuhësore kanë qenë kryefjalë e veprimit tonë politik bashkë me zbatimin e tërësishëm të Marrëveshjes së Ohrit dhe ne sot ia arritëm qëllimit. Kjo nuk do të arrihej dot pa mbështetjen e qytetarëve dhe miqve ndërkombëtarë të cilëve u shpreh mirënjohjen time dhe të Bashkimit Demokratik për Integrim.

**"Epoka e re":** Çfarë vlerësimi keni për këtë qeverisje, ku pjesë e saj është edhe partia juaj?

Ahmeti: Kjo qeverisje lindi nga një krizë e thellë sistemore, politike dhe integruese në vendin tonë. Shpesh krizat

paraqesin edhe mundësi. Pikërisht ne arritëm që krizën ta shndërrojmë në mundësi dhe të mbyllim shumë tema dekadëshe në vend. Ne si parti premtuam integrim në NATO dhe bisedime për anëtarësim në Bashkimin Evropian, barazi gjuhësore, sundim të së drejtës, zhvillim ekonomik dhe, nëse ndaleni për një çast dhe vlerësoni punët e realizuara në më pak se dy vjet qeverisje, do të vini re që shumicën dërrmuese të zotimeve tona parazgjedhore i kemi realizuar. Duhet të jemi krenarë që po i jetojmë këto ditë dhe kemi mundësinë të jemi kontribuues në këto procese historike. Por, ende kemi edhe shumë punë për të bërë dhe neve nuk na mungon as vullneti, as dija, as energjia për t'u ballafaquar me sfidat vijuese.

**"Epoka e re":** Ka gjasa që ky koalicion qeverisës do të mund ta anëtarësojë vendin edhe në Bashkimin Evropian?

Ahmeti: Anëtarësimi i vendit në

Bashkimin Evropian është proces kompleks që kërkon transformim shoqëror dhe reformues që zgjat një periudhë të caktuar. Besoj se në këtë mandat ne do t'i fillojmë bisedimet për anëtarësim në Bashkimin Evropian, ndërsa uroj që anëtarësimin e plotë ta arrijmë në vitin 2025.

**"Epoka e re":** Po zbatohet plotësisht Ligji për gjuhët?

Ahmeti: Barazia gjuhësore është një themel tjetër i barazisë të tërësishme të dy komuniteteve shumicë në vend dhe jam i lumtur që arritëm miratimin e këtij ligji. Miratimi i këtij ligji që rrumbullakoi pjesën normative të marrëveshjes së Ohrit është e arritur e jashtëzakonshme që më bën shumë krenar. Tashmë ka filluar zbatimin e dygjuhësisë në vend dhe vlerësoj se nga barazia nuk humbet askush, përkundrazi fiton vendi dhe qytetarët. Tashmë jemi në proces të

# ent që pranohet nga të gjithë



themelimit të Agjencisë për zbatimin e gjuhës si dhe inspektoratit që rrjedhin si obligim nga ky ligj. Së shpejti do t'i shohim tabelat e institucioneve edhe në gjuhën shqipe dhe vlerësoj se të gjithë do ta respektojnë dhe zbatojnë ligjin.

**"Epoka e re":** Kryetar, më 21 prill do të mbahen zgjedhjet presidenciale. Sa jeni të përgatitur për këtë proces zgjedhor dhe a do të ketë BDI-ja kandidatë të vetin apo e përkrah një kandidat konsensual?

Ahmeti: Qysh nga viti 2014 ne kemi promovuar konceptin e një kandidati për president për të cilin do të merreshim vesh, të dakorduar midis dy përfaqësuesve legjitimë të dy komuniteteve shumicë, një kandidat konsensual. Jemi të gatshëm të dalim edhe vetë me kandidat, por edhe me një kandidat të dakorduar paraprakisht dhe të pranueshëm. Unë shtriva dorën e bashkëpunimit deri te partitë

politike shqiptare, por me keqardhje prita refuzimin e tyre të menjëhershëm. Sidoqoftë, vendit i duhet një president i pranuar nga të gjithë qytetarët.

**"Epoka e re":** Opozita ka kërkuar që së bashku me zgjedhjet presidenciale të mbahen edhe zgjedhjet parlamentare të parakohshme, por një gjë e tillë nuk ndodhi. Pse?

Ahmeti: Puna e opozitës është që të kritikojë dhe të ofrojë zgjidhje më të mira sesa qeveria dhe normalisht ta kërkojë shansin në zgjedhje, por një opozitë e shëndoshë duhet të ketë në radhë të parë interesin e qytetarit dhe të vendit. Në një periudhë kur sapo kemi nënshkruar protokollin për anëtarësim në NATO dhe sapo ka filluar procesi i ratifikimit të këtij protokollit në parlamentet e vendeve anëtare, por edhe në kohën kur kemi për detyrë miratimin e ligjeve reformuese që ta konfirmojmë datën për

fillim të negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian, më duket e papërgjegjshme të kërkojmë zgjedhje të parakohshme. Neve si parti na konvenon të kemi zgjedhje sot, por nuk mund të radhitemi në rreshtin e papërgjegjshëm të opozitës shqiptare, megjithatë ne jemi parti serioze që ndërmerr mbi supe procese të mëdha dhe nuk mund të shfaqemi oportunistë para partnerëve euro-amerikanë dhe të ardhmes.

**"Epoka e re":** Z. Ahmeti, si i

komentoni zhvillimet në Kosovë, përkatësisht çështjen e taksës dhe dialogun me Serbinë? Cilat janë pritjet e juaja nga ky proces?

Ahmeti: Viti 2019, me sa duket, është vit i vendimeve të mëdha dhe transformimit të tërësishëm të Evropës Juglindore, nga një vatër e pasigurisë dhe krizës, në një rrëfim sukcesi për kontinentin tonë. Kosova dhe Serbia me doemos duhet ta arrijnë njohjen e ndërsjellë dhe ta vijëzjnë kufirin shtetëror midis dy vendeve. Institucionet e Kosovës e kanë legjitimitetin e

plotë për t'i zhvilluar këto bisedime dhe për të arritur kompromis me mbështetjen e plotë të Bashkimit Evropian dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Vlerësoj se në 100-vjetorin e Konferencës së Versajës ne kemi për detyrë dhe obligim t'i përmirësojmë pasojat e shkaktuara nga lufta akoma e papërfunduar e Parë Botërore dhe ta integrojmë rajonin tonë aty ku përkon, në Bashkimin Evropian, në paqe, siguri dhe stabilitet dhe me perspektivë ekonomike dhe zhvillimore.

## MASHT-i vendos t'i kompensojë orët e humbura të mësimimit nga greva

PRISHTINË, 11 SHKURT (ER) - Ministri i Arsimit, Shyqyri Bytyqi, ka takuar të hënën drejtorët e Drejtorive Komunale të Arsimit (DKA), me të cilët ka biseduar për shumë çështje të arsimit dhe për përgatitjet për procese të rëndësishme në arsimin parauniversitar. "Në takim diskutuam për mundësitë e zëvendësimit të orëve të humbura gjatë grevës në arsim dhe për kohën më të përshtatshme kur mund të bëhet ky zëvendësim. Pas diskutimeve të shumta dhe sugjerimeve të marra nga përgjegjësit e arsimit nëpër komuna, MASHT-i do të dalë

me një vendim të hollësishëm për kompensimin e orëve të humbura", ka thënë pas takimit Bytyqi. Ai ka treguar se biseduan edhe rreth zbatueshmërisë së vendimit për ndalimin e përdorimit të telefonave nga ana e nxënësve dhe mësimdhënësve gjatë procesit mësimor. "Theksova se vendimi duhet të zbatohet në tërësi në bazë të Udhëzimit Administrativ dhe kërkoja raporte nga DKA-të rreth zbatueshmërisë së këtij vendimi. Rreth kësaj çështje paralajmërova se do të merren masa ndëshkuese dhe do të bëhen publikë të gjithë

emrat e shkollave të cilat nuk marrin masa rreth zbatimit të këtij vendimi", ka deklaruar ministri Bytyqi. Ai ka përgëzuar komunat të cilat janë duke e zbatuar vendimin, në veçanti Komunën e Hanit të Elezit, në të cilën në dy ditët e para të hyrjes në fuqi të vendimit janë konfiskuar rreth 60 telefona. "Me drejtorët e arsimit diskutuam edhe për përgatitjet për Maturën 2019, me ç'rast paralajmëruam fillimin e debateve nëpër komuna, në mënyrë që ky proces i rëndësishëm të jetë sa më i organizuar dhe të nxirren rezultate sa më reale", ka thënë ministri Bytyqi.



## Takohen në Tiranë tre zëvendësministrit shqiptarë të Mbrojtjes

TIRANË, 11 SHKURT (ER) - Të hënën në Tiranë, zëvendësministri i Mbrojtjes, Burim Ramadani, u prit në takim zyrtar nga zëvendësministri i Mbrojtjes së Shqipërisë, Petro Koçi. Në takim e përbashkët ishte edhe zëvendësministri i Mbrojtjes së Maqedonisë së Veriut, Bekim Maksuti.

Takimi në Ministrinë shqiptare të Mbrojtjes kishte karakter diskutimi të përbashkët mbi

përvojat në rajon në rrugën e integritimit në NATO dhe për bashkëpunimin e mëtutjeshëm midis shteteve në çështjet e politikave të sigurisë dhe mbrojtjes. Zëvendësministri Burim Ramadani ka vlerësuar lart takimin konsultues të këtij formati, duke theksuar dëshirën për zgjerimin e përfaqësimit edhe të shteteve të tjera në rajon. "Rajoni ynë dhe shtetet tona kanë nevojë të vazh-

dueshme për shkëmbimin e përvojave në proceset integruese si dhe për thellimin e bashkëpunimit për t'i promovuar vlerat perëndimore të rajonit", ka thënë Ramadani. Ai ka theksuar se Kosova është e përkushtuar në rrugën drejt NATO-s dhe se anëtarësimi i shteteve të Ballkanit në NATO është alternativa më e sigurt për zhvillimin e rajonit të sigurt dhe prosperues.



# Kosova shënjon vendet e trashëgimisë dhe ato turistike

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 11 SHKURT - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka nënshkruar të hënën Udhëzimin Administrativ (MKRS) nr. 01/2019 për specifikat e shënimit të trashëgimisë kulturore dhe vendeve turistike, akt nënligjor ky i cili ka për qëllim t'i përcaktojë llojet, kuptimin, formën, ngjyrën, dizajnin, madhësinë dhe fontin e shkronjave, dimensionet, materialin dhe karakteristikat teknike të shenjzimit si dhe udhëzimet për standardet për vendosjen dhe instalimin e shenjave të trashëgimisë kulturore dhe atyre turistike në të gjitha kategoritë e rrugëve në Republikën e Kosovës.

Këto shenja njoftuese/informuese, në bazë të udhëzimit, do të zbatohen në tërë territorin e Kosovës dhe janë të dedikuara për informim, gjegjësisht për ta drejtuar shfrytëzuesin deri te potencialet/destinacionet e trashëgimisë kulturore dhe turistike. Shenjat sipas këtij udhëzimi janë: Shenja "shënim kulturor-historik"; Shenja "atraksion natyror"; Shenja "objekt për strehim"; Shenja "objekt hotelier"; Shenja "objekt publik"; Shenja "atrak-

sion turistik"; Shenja "rrugë turistike"; Shenja "Mirë se vini" dhe "Lamtumirë"; Shenja "tabela turistike informuese, për komunikacion, turizëm dhe informacione të tjera turistike". Format e këtyre shenjave do të jenë katrore, katërkëndëshe dhe në formë shigjete dhe kanë ngjyra të kafta, të kaltra, gjelbra dhe të bardha.

Gjithashtu, shenjat i kanë kodet e tyre të cilat ndahen në: E 1.x - simboli i trashëgimisë kulturore; E 2.x - simboli për shërbime; E 3.x - simboli për rekreacion. Ndërsa numrat do të shënohen prej 01 deri 99 për secilën kategori të sinjalizimit. Shenjat përmbajnë simbole të paraqitura në formë të piktogramit dhe tekste të shkruara sipas nevojës. Ndërkaq, dimensionet e shenjave sipas llojit të tabelave fillojnë nga minimumi 20 x 20 cm deri në maksimum 6 m<sup>2</sup>.

Me këtë rast, ministri Gashi ka vlerësuar se nëpërmjet këtij Udhëzimi Administrativ qartësohen shenjat orientuese për vendet e trashëgimisë kulturore dhe ato turistike. "Ky akt nënligjor mundëson dhe qartëson që Republika e Kosovës të shënohet me simbole orientuese të trashëgimisë kulturore dhe për vendet turistike e që ua lehtëson



turistëve vendorë e ndërkombëtarë që gjejnë më lehtë destinacionin që u intereson. Me këtë akt, ne kemi përmbushur edhe një standard për trashëgimi dhe turizëm dhe kjo bën që ne të afrohem edhe një hap me

standardet evropiane e ndërkombëtare", ka thënë ministri Gashi.

Ai është zotuar që këtë vit do të hartohen e miratohen edhe akte të tjera që përmirësojnë dhe konkretizojnë fushat

përkatëse ashtu që qytetarët e Kosovës, si dhe turistët e huaj, ta kenë më të lehtë realizimin e nevojave dhe qëllimeve të tyre në vendin tonë konform rregullave dhe dispozitave ligjore të Republikës së Kosovës.

## PDK-ja vazhdon zgjedhjen e strukturave të reja

PRISHTINË, 11 SHKURT (ER) - Partia Demokratike e Kosovës (PDK) po vazhdon mbajtjen e kuvendeve zgjedhore nëpër nëndegë në shumicën e komunave të Kosovës, ndërsa në shumicën e nëndegëve PDK-së po i bashkohen anëtarë të rinj të profileve të ndryshme. "Procesi i brendshëm zgjedhor në Partinë Demokratike të Kosovës po vijon sipas planit të hartuar nga Komisioni për zgjedhje të brendshme, në pajtim me rregulloret dhe procedurat e miratuara nga organet partiake,

për ta jetësuar vizionin e kryetarit të PDK-së, Kadri Veseli, për 'Dekadën e Re'. Interesimi dhe angazhimi i anëtarësisë dhe qytetarëve për t'u zgjedhur në strukturat e reja të PDK-së për 'Dekadën e Re' është më i madh se asnjëherë më parë, ndërsa në shumë kuvende zgjedhore ka pasur qindra delegatë që kanë marrë pjesë në zgjedhje", është thënë në komunikatën e PDK-së. Vetëm në Kuvendin Zgjedhor të Nëndegës së Pestë në Skenderaj pjesëmarrës ishin mbi 300 dele-

gatë. "Në shumicën e kuvendeve zgjedhore gara për strukturat e reja të PDK-së po zhvillohet nga së paku dy kandidatë për kryetarë të nëndegëve, ndërsa në shumicën e nëndegëve janë zgjedhur përfaqësues të rinj, duke konfirmuar procesin e reformave në të gjitha nivelet. Deri tani kuvendet zgjedhore janë mbajtur në 480 nëndegë, nga 1 200 sa ka gjithsej Partia Demokratike e Kosovës në të gjitha komunat e Kosovës", është theksuar në këtë komunikatë.



# AShAK-u kundërshton idenë për ndryshimin e kufirit Kosovë - Serbi

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës (AShAK) ka reaguar lidhur me diskursin rreth sovranitetit dhe integritetit territorial të Republikës së Kosovës. AShAK-u ka kërkuar nga spektri politik që ta mbrojë tërësinë dhe sovranitetin e vendit. Sipas AShAK-ut, diskursi për ndryshimin e kufirit në mes të Kosovës dhe Serbisë është me pasoja të dëmshme

**EPOKA  
ERE** **Faton DERMAKU**

PRISHTINË, 11 SHKURT - Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës (AShAK) të hënën nëpërmjet një deklarate për media ka shprehur shqetësimin për diskursin politik lidhur me fazën e fundit të dialogut me Serbinë. Sipas kësaj akademie, diskursi i tensionuar për ndryshimin e kufijve midis Kosovës dhe Serbisë si ide dhe plan i vjetër serb, në

formë të korigjimit, shkëmbimit dhe ndarjes së Kosovës është me pasoja shumë të dëmshme për pavarësinë, sovranitetin shtetëror dhe integritetin territorial të Kosovës dhe interesave të saj. AShAK-u e ka quajtur të papranueshme mungesën e platformës unike shtetërore dhe qëndrimet përçarëse në mes të bartësve të institucioneve kryesore të Kosovës. "Një konsensus politik e kombëtar është i domos-

doshëm në mënyrë që procesi i dialogut të përmbillet me sukses të plotë dhe në përputhje me interesat e Republikës së Kosovës. Republika e Kosovës fazën përfundimtare të dialogut duhet ta zhvillojë në koordinim dhe në bashkërendim të ngushtë me aleatët perëndimorë, si ShBA-në dhe BE-në, në mënyrë që përfaqësimi dhe mbrojtja e interesave kombëtare në këtë proces, të jetë vijimësi e kontributit të partnerëve strategjikë, sikurse në fazën e luftës për liri, për shtet, për paqe, për siguri dhe për stabilitet rajonal", është thënë në reagimin e Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Seksionit të Arteve të AShAK-ut. AShAK-u ka kërkuar nga presidenti, kryeministri, e në veçanti nga deputetët e Kuvendit të Kosovës, që të qëndrojnë të palëkundur për mbrojtjen e tërë-

sisë dhe të sovranitetit territorial të Republikës së Kosovës. "Republika e Kosovës fazën përfundimtare të dialogut me Republikën e Serbisë duhet ta zhvillojë brenda kuadrit kushtetues dhe ligjor në fuqi dhe në mbështetje të kompetencave kushtetuese të institucioneve shtetërore. Republika e Kosovës fazën përfundimtare të dialogut duhet ta zhvillojë në zbatim të obligimeve të pranuar ndërkombëtare konform Rezolutës së Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, A/RES/64/298 të 9 shtatorit 2010 me të cilën pranohet opinioni këshillues i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë mbi përputhshmërinë e Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës me të Drejtën Ndërkombëtare, me të cilën është hapur rruga për të hyrë në dialogun ndërshtetëror

me Republikën e Serbisë, të ndihmuar nga Bashkimi Evropian. Republika e Kosovës mund të zhvillojë fazën përfundimtare të dialogut, përballë Serbisë a palëve të treta, vetëm si shtet i pavarur, sovran, i njohur ndërkombëtarisht nga 115 shtete dhe i konfirmuar nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë", është theksuar në reagimin e kësaj akademie.

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës (AShAK) ka vlerësuar se Kosova nuk duhet të lejojë të negociohet çfarëdo ndryshimi i kufirit midis Kosovës dhe Serbisë, në formë të korigjimit, të shkëmbimit dhe të ndarjes së Kosovës, sepse kjo do të kishte pasoja të pariparueshme për shtetësinë dhe subjektivitetin ndërkombëtar të Kosovës. "Çdo ndarje territoriale-etnike e Kosovës, jashtë kufijve të përcaktuar qartë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, do ta rrezikonte mosekzistimin e saj si shtet i pavarur dhe sovran, sikundër që copëtimi i Luginës së Preshevës do ta fshinte atë si entitet. Çdo diskutim për çështjen e kufijve do ta rrezikonte presionin aktual të Bashkimit Evropian ndaj Republikës së Serbisë për decentralizimin e pushtetit në favor të autonomisë lokale e cila do të ndikonte në zhvillimin e Luginës së Preshevës", është theksuar më tutje në këtë reagim.

Sipas AShAK-ut, Kosova fazën përfundimtare të dialogut duhet ta shfrytëzojë si mundësi të papërsëritshme për avancimin e pozitës kushtetuese dhe të drejtave legjitime të shqiptarëve të Preshevës, Bujanocit dhe të Medvegjës, paralelisht me ato të serbëve të Kosovës mbi bazën e parimit të reciprocitetit.



## Ministri Mustafa i përkushtuar që të vazhdohet respektimi i Ligjit për Barazi Gjinore

PRISHTINË, 11 SHKURT (ER) - Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), bashkë me organet e veta, është e përkushtuar të ndërmarrë të gjitha veprimet ligjore për të ofruar siguri për të gjithë qytetarët, pronën publike dhe private në Republikën e Kosovës. Ministri i Punëve të Brendshme, Ekrem Mustafa, mbështet ruajtjen e integritetit dhe kultivimin e mëtutjeshëm të kredibilitetit të autoriteteve me rol të rëndësishëm si: Policia e Kosovës, Inspektorati Policor i Kosovës, Akademia e Kosovës për Siguri Publike, Agjencia për Menaxhim Emergjent, Agjencia për Regjistrim Civil dhe Agjencia e Kosovës për

Forenzikë jo vetëm në raport me qytetarët dhe opinionin publik, por edhe për të siguruar që këto organe shtetërore do të jenë garant i standardeve më të larta profesionale edhe për pjesëtarët e tyre, të cilët në baza ditore japin kontribut të çmuar. "Duke e pasur parasysh se Republika e Kosovës ka kornizë ligjore dhe institucionale për arritjen e barazisë gjinore, duke e vlerësuar nevojën për avancim të mëtutjeshëm të barazisë gjinore, si dhe me qëllim të arritjes së barazisë së plotë gjinore në plan profesional, me rastin e planifikimit të rekrutimit të stafit në të gjitha nivelet, ministri Mustafa kërkon që, përveç akteve të cilat rregullojnë

marrëdhënien e punës, të vazhdohet të respektohet edhe Ligji Nr. 05/L -020 për Barazi Gjinore", është bërë me dije në komunikatën e MPB-së. Sipas kësaj komunikate, kjo kërkesë e parashtruar ka pritur legjitime që të arrihet përfaqësim më i madh në të gjitha pozitat, edhe ato udhëheqëse, në organet e administratës shtetërore të MPB-së dhe gjithë kjo është në funksion të sigurimit të rendit dhe ligjit, si dhe ruajtjes së integritetit, kredibilitetit dhe besimit të qytetarëve në autoritetet e sigurisë. "Ministri Mustafa shpreh mirënjohjen dhe konsideratat më të larta për të gjithë zyrtarët dhe pjesëtarët e MPB-së dhe agjencive të saj të



cilët me përkushtim të jashtëzakonshëm zbatojnë të gjitha obligimet kushtetuese e ligjore

për një ambient më të sigurt për të gjithë qytetarët", është theksuar në komunikatën e MPB-së.

# Vajza dhe djali i Fahredin Gashit: Babai ynë është i pafajshëm, të lirohet sa më shpejt

PRISHTINË, 11 SHKURT (ER) - Vajza e Fahredin Gashit, Frontina, në një postim në llogarinë e vet në "Facebook" ka thënë se babai i saj është i pafajshëm. Në nëntor të vitit 2011 Gjykata e Qarkut në Prishtinë kishte dënuar me 18 vjet burgim Fahredin Gashin, nën akuzat për vrasjen e Salih Gashit, më 15 qershor 1999, në fshatin Varigovc të Lipjanit. Aktakuza ndaj Gashit u ngrë pas dëshmiave publike të Nazim Bllacës, i cili pati pranuar se ka marrë pjesë në vrasje dhe krime të tjera që, sipas tij, ishin të urdhëruara nga ShIK-u. Së fundmi, Nazim Bllaca, në një dokumentar të RTK-së, paraqitej si spiun i Serbisë në Kosovë dhe i lidhur me UDB-në.

Frontina Gashi ka thënë se është pikërisht Nazim Bllaca ai që ka faj për dënimin me burg të babait të saj. Vajza e Fahredin Gashit përmes kësaj deklarate tregon se kur kishte



lindur ajo nuk e kishte pasur afër babanë, sepse ai ishte pjesë e luftës çlirimtare, UÇK-së. "Unë as në këtë fotografi nuk e kisha babanë afër. Në këtë moment që unë kam lindur nuk ai ishte pranë meje. Pse? Sepse ishte pjesë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) në ato momente kur linda. Ai ishte duke luftuar për lirinë që ne sot po e gëzojmë, ndërsa ata që luftuan për ta gëzuar këtë liri që kemi sot,

janë në burg pa faj, për shkak të spiunëve serbë siç është Nazim Bllaca, por të vërtetat e tij dolën me fakte, të cilat tregojnë se ai ishte agjent i BIA-së serbe që nga viti 1997", ka thënë Frontina Gashi, vajza e Fahredin Gashit.

Frontina ka bërë thirrje që babai i saj dhe të tjerët që luftuan për çlirimin e vendit të lirohen. "Secili nga ju dëshiron që t'i ketë prindërit afër. Edhe unë dua ta kem babanë afër, sepse nuk e

meriton atë vend ku është sot. Ata të gjithë janë të pafajshëm. Përderisa pafajësia e tyre doli në dritë, ata ende po i mbajnë të burgosur. Dhe kjo të dhembë më së shumti kur e di që pa faj po qëndron në atë vend. Të lirohen sa më shpejt ata që dolën të pafajshëm dhe që ende po qëndrojnë në burg. Të lirohen ata që luftuan për ne, për të na mbrojtur neve dhe vendin tonë. Siç luftuan ata për të na mbrojtur neve, edhe ne duhet të luftojmë tani për t'i mbrojtur ata. Duam drejtësi", ka thënë vajza e Fahredin Gashit, Frontina.

Në një postim në llogarinë e vet në "Facebook", ka reaguar edhe djali i Fahredin Gashit, Albioni. "Duke u bazuar në emisionin e fundit 'Udhëve', ku u bindën të gjithë se babai im është i pafajshëm dhe u dënua vetëm me fjalët e një spiuni serb, lind pyetja çka tash?", ka shkruar Albion Gashi. "Kush na rikthen lotët dhe vuajtjet për nëntë vjet? Kush na rikthen vitet që i humbëm pa

baba, pa burrë, pa djalë dhe pa vëlla? Kush na rikthen mungesën e tij në festa që çdoherë i kemi kaluar me lot? Kush na rikthen mungesën e tij në momentin e diplomimit të fëmijëve të tij? Kush na rikthen mungesën e tij në martesat e fëmijëve të tij? Kush ia rikthen mungesën e përjetimit të ndjenjës së të bërit gjysh? Kush na rikthen shëndetin e babit? Kush na rikthen nëntë vjet të jetës sonë që aspak nuk ka qenë e njëjtë pa të? Të gjithë keni familje dhe s'mund të rrini larg saj më shumë se 3-4 ditë. Babai ynë është larg nesh që 3 285 ditë, pa asnjë arsye. Prania e tij na mungon shumë", ka shkruar Albioni, duke bërë apel që të lirohet sa më shpejt babai i tij. "Ju lutem të gjithëve në qeveri dhe gjykatës, boll. Është koha ta lironi sa më shpejt që është e mundur dhe t'u jepni fund vuajtjeve tona. Babi, të duam shumë", ka shkruar djali i Fahredin Gashit, Albioni.

## Klinika e Ortopedisë, prioritet i investimeve në ShSKUK

PRISHTINË, 11 SHKURT (ER) - Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës, në kuadër të prioritetëve, përveç Klinikës së Kardiologjisë Invazive dhe Oftalmologjisë, e ka futur edhe Klinikën e Ortopedisë, duke ndarë mjete për ofrimin e shërbimeve mjekësore të cilat kanë munguar aty në vitet e shkuara dhe pacientët është dashur të kërkojnë shërim jashtë vendit. Nga buxheti i ShSKUK-së për vitin 2019, për këto klinika janë dhënë më shumë se 2 milionë euro. Drejtori i Klinikës së Ortopedisë, Arbër Tolaj, ka thënë se mjetet do të destinohen për pajisje mjekësore dhe materiale shpenzuese që nuk janë të përfshira në listën esenciale. Në mungesë të buxhetit, Tolaj thekson se më herët ka qenë e pamundur të përmblidhen kërkesat e pacientëve dhe kështu, përmes Ministrisë së Shëndetësisë, ata është dashur të dërgohen për trajtim jashtë Kosovës, me shpenzime shumë më të mëdha, duke rënduar buxhetin e shtetit. "Sipas një përlloraritje që kemi bërë,

me 600 mijë euro ne do të mund t'i realizojmë dhe t'i përmbushim të gjitha këto kërkesa për pacientët, të cilët do të trajtohen brenda vitit 2019 për lloje të patologjive të ndryshme", ka deklaruar Tolaj. Me funksionalizimin e sallës së katërt, që pritet të ndodhë shumë shpejt, Tolaj thekson se lista e pritjes për proteza dhe ligamente do të zvogëlohet dukshëm, i bindur që nuk do të shkojë gjatë në kohë dhe ajo do të hiqet krejt.

Me sallën e re dhe mjetet e ndara, ai beson se do të ketë numër më të madh të shërbimeve, mes tyre edhe disa operacione specifike në kirurgjinë spinale, të pakryera më herët. "Materialin tjetër, të cilin e kemi planifikuar që të përdoret, është materiali për kirurgji spinale, edhe pse setin për ndërhyrje primare në boshtin kurrizor e kemi. Sikurse për nyjat e tjera të gjurit, kërdhokullës, krahut edhe në pjesën e kurrizit, me ardhjen e materialit kemi mundësi të kryejmë disa operacione specifike", është shprehur Tolaj.



## Bytyqi merr vendim për vendosjen e kutive të ankesave në institucionet arsimore

PRISHTINË, 11 SHKURT (ER) - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, ka marrë vendim që në të gjitha

institucionet arsimore të arsimit parauniversitar në Republikën e Kosovës të vendosen kutitë e ankesave. Për zbatimin e këtij

vendimi ministri ka obliguar drejtoritë komunale të arsimit, ndërsa kutitë e ankesave do të jenë nën menaxhimin e

Inspektoratit të Arsimit për një periudhë kalimtare (minimumi një vit). Këtë vendim ministri Bytyqi e ka marrë me qëllim që

të mundësohet parashtrimi i ankesave eventuale lidhur me parregullsitë në institucionet e arsimit parauniversitar.



# Haradinaj: Jemi përcaktuar që prodhuesve të vendit t'u japim më shumë përkrahje

PRISHTINË, 11 SHKURT (ER) - Kryeministri Ramush Haradinaj gjatë vizitës në kompaninë "Gacaferi" në Pejë ka thënë se Qeveria e Kosovës është përcaktuar që ky vit të jetë viti i ekonomisë, i prodhuesve, përpunuesve dhe kompanive të vendit.

Me këtë rast, kryeministri Haradinaj u prit nga pronari Naim Gacaferi me bashkëpunëtorë, nga i cili është njoftuar për punët, të arriturat dhe sfidat me të cilat përballë kompania, e cila ka traditë rreth 60-vjeçare. "Jam rritur me emrin Gacaferi dhe nuk ka dikush në Kosovë që nuk e di për kompaninë 'Gacaferi'. Janë njerëz të respektuar jo vetëm në Pejë, e në këtë trevë, por prodhimet e kësaj kompanie e kanë marrë besimin edhe në tregjet e jashtme, si në Zvicër, Gjermani, etj", ka thënë kryeministri Haradinaj, duke theksuar se tani prodhuesit tanë e kanë më të lehtë të punojnë, meqë lënda e

parë dhe pajisjet janë të lira nga taksat. Ai ka thënë se pikërisht në frymën e këtyre lehtësirave po zhvillohet edhe kjo vizitë, për t'i parë nga afër mundësitë për përkrahjen e bizneseve vendore. Kurse pronari Naim Gacaferi ka falënderuar kryeministrin Haradinaj për vizitën, duke thënë se mbështetja e tij për bizneset vendore është ndihmë e madhe. "Vitin e kaluar kemi pasur ngritje afër 30 për qind me eksport, ndërsa këtë vit presim që të realizojmë deri në 45 për qind", ka deklaruar Gacaferi. Ai ka të punësuar rreth 50 punëtorë dhe, përveç tregut vendor, kjo kompani eksporton prodhimet edhe në vende të ndryshme të Evropës. Vizita e kryeministrit Haradinaj në fabrikën "Gacaferi" po zhvillohet në vazhdim të vizitave për ta mbështetur dhe fuqizuar sektorin privat dhe zhvillimin ekonomik të vendit, në kuadër të vitit ekonomik, i shpallur nga Qeveria e Kosovës.



# Rritet bashkëpunimi në sektorin energjetik në mes të Kosovës dhe Maqedonisë

Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, dhe ministri i Ekonomisë së Maqedonisë, Kreshnik Bekteshi, kanë zhvilluar të hënën një takim të përbashkët në Shkup, ku kanë diskutuar për projekte të përbashkëta në fushën e energjisë si dhe për thellimin e bashkëpunimit në mes të Kosovës dhe Maqedonisë në fushën e ekonomisë. Të dy ministrat nënshkruan edhe një memorandum mirëkuptimi në fushën e energjetikës

**EPOKA  
ERE** **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 11 SHKURT - Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, ka zhvilluar të hënën një takim në Shkup me ministrin e Ekonomisë të Maqedonisë, Kreshnik Bekteshi, me të cilin ka diskutuar për projekte të përbashkëta në fushën e energjisë si dhe për thellimin e bashkëpunimit në mes të Kosovës dhe Maqedonisë. Ministri Lluka ka shprehur interes për projektin e gazifikimit pasi hap mundësi për zhvillimin e këtij rrjeti në të dy vendet, duke theksuar se shkëmbimi i përvojave për zhvillimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë do të ishte e dobishme për të arritur qëllimet brenda përmbushjes së kërkesave të komunitetit të energjisë. "Përgatitja e projekteve të përbashkëta do t'u mundësojë dy vendeve prezantim të përbashkët para institucioneve të huaja financiare në mënyrë që të angazhohen fonde për

realizimin e projekteve të përbashkëta", u shpreh ministri Lluka.

Kreu i ekonomisë maqedonase, Kreshnik Bekteshi, ka thënë se projekt aktual ndërmjet Kosovës dhe Maqedonisë është revitalizimi i linjave 220kV drejt Kosovës. "Në periudhën e ardhshme, projekti aktual për realizimin nga të dy vendet është lidhja e sistemeve energjetike mes dy vendeve me revitalizimin e linjave 220 kV drejt Kosovës. Kjo do të nënkuptonte edhe një lidhje tjetër me sistemet energjetike të BE-së sepse Kosova nëpërmjet Shqipërisë do të lidhet me Italinë, që do të thotë rritje e besueshmërisë në sistemin tonë të transmetimit të energjisë elektrike", ka thënë ministri Bekteshi

Ndër temat e diskutuara në këtë takim ishin termocentrali i Oslomejit dhe furnizimi i saj i mundshëm me thëngjill me kalori të lartë nga Kosova, pastaj HC Çebren dhe Galishtë, si balancues potencial në sistemet e elektroenergjetikës në rajon, si



dhe projektet investuese të të dyja palëve që nënkupton monitorimin e tranzicionit evropian të energjisë. Në këtë takim u diskutuan edhe mundësitë për zgjerim me projektin për sistemin e një sporteli, ndërsa operacionalizimin e disa prej projekteve të lartpërmendura mund të sjellë edhe mbledhja e përbashkët në mes të Qeverisë së Maqedonisë dhe Qeverisë së Kosovës, planifikuar të mbahet kah mesi i këtij viti. Pas përfundimit të takimit të

punës ndërmjet delegacioneve të të dy vendeve, ministri Lluka dhe ministri Bekteshi nënshkruan edhe memorandum mirëkuptimi në fushën e energjetikës, i cili pritet t'i shtojë marrëdhëniet dypalëshe në sektorin e energjisë, duke përcaktuar fushat kryesore për bashkëpunim të tillë në sektorin e energjisë elektrike, të thëngjillit, gazit natyror, burimeve të ripërtëritshme të energjisë, efikasitetit energjetik, furnizimit të sigurt me energji, si dhe

përgatitjes së projekteve të rëndësishme infrastrukturore për ndërlidhje me energji elektrike dhe gaz dhe nisma të tjera projektuese. Të dy ministrat u morën vesh që marrëdhëniet ndërfaqjësore midis Republikës së Kosovës dhe Republikës së Maqedonisë janë në nivelin më të lartë të mundshëm deri tani, të cilat duhet të shfrytëzohen për thellimin dhe zgjerimin e bashkëpunimit në të gjitha fushat.

# Një kompani franceze e interesuar të investojë 122 milionë euro në Qyqavicë

**DRENAS, 11 SHKURT (ER)** - Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, ka pritur të hënën në takim ambasadorin e Francës në Kosovë, Didier Chabert, me të cilin ka diskutuar për çështje të rëndësishme për investimet që mund të zhvillohen në këtë komunë. Lladrovci ka falënderuar ambasadorin francez për vizitën dhe kontributin që Franca ka dhënë për shtetformimin e Kosovës si dhe për mbështetjen që u ka dhënë bizneseve franceze në Kosovë. Ai ka shtuar se Komuna e Drenasit i ka dyert e hapura për investimet franceze në Kosovë dhe çdo vendi tjetër demokratik, në veçanti vendeve mike të Kosovës, gjithmonë duke u bazuar në kornizat ligjore që ka



Kosova. Ndërsa ambasadori Chabert ka falënderuar kryetarin Lladrovci

për mikpritjen dhe ka njoftuar se një kompani franceze dëshiron të investojë në projektin për

energji të ripërtërishme (mullinjtë të erës) në vlerë prej 122 milionë eurosh në lokacionin e

Qyqavicës ku do të përfshihet edhe territori i Komunës së Drenasit.

Ambasadori francez ka kërkuar që t'u jepet mundësi bizneseve franceze në mënyrë që të mos shkojnë në vende të tjera.

Kryetari Lladrovci ka njoftuar të pranishmit se pesë komunat që përfshihen në zonën e Qyqavicës, vitin e kaluar kanë nënshkruar memorandum bashkëpunimi dhe e kanë ratifikuar këtë memorandum në asambltetë e tyre, që kjo pjesë të jetë zonë me interes të veçantë. Ai ka theksuar se duhet shikuar mundësitë nëse lejohet ndërtimi i mullinjve të erës në këtë pjesë, duke u pajtuar edhe me kryetarët e komunave të tjera që janë pjesë e memorandumit.

## Muharremaj takon fëmijët e kopshtit 'Melodia'

**THERANDË, 11 SHKURT (ER)** - Kryetari i Komunës së Therandës, Bali Muharremaj, ka vizituar të hënën fëmijët e kopshtit "Melodia" në këtë komunë. Me këtë rast, Muharremaj është zotuar se do të punojnë bashkërisht për të krijuar një të ardhme më të

mirë për fëmijët e Therandës. "Në Kopshtin 'Melodia' sot takova fëmijët të cilët ishin me shumë energji e vullnet. Ne duhet të punojmë bashkë pa asnjë dallim, për të krijuar një të ardhme të ndritur për ta", ka thënë Muharremaj pas kësaj vizite.



## Malisheva bëhet gati për shënimin e 17 shkurtit

**MALISHEVË, 11 SHKURT (ER)** - Këshilli i drejtorëve në Komunën e Malishevës, nën drejtimin e kryetarit të komunës, Ragip Begaj, ka mbajtur mbledhjen e rregullt, në të cilën drejtorët e drejtorive kanë raportuar për aktivitetet e javës së kaluar si dhe për planifikimet për këtë javë. Në mesin e shumë çështjeve që janë diskutuar, është njoftuar

edhe për përgatitjet për shënimin e 17 shkurtit, ditës së shtetësisë së Kosovës.

Sipas Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, janë duke u bërë të gjitha përgatitjet për shënimin e 17 shkurtit, ditës së shtetësisë së Republikës së Kosovës, ku janë paraparë të zhvillohen një varg aktivitetesh kulturore dhe sportive si dhe, në bashkëpunim me sektorë të tjerë, edhe

aktivitete të tjera tradicionale. Krahas mbledhjes solemne të Kuvendit të Komunës, do të bëhen edhe homazhe dhe nderime në varrezat e dëshmorëve në Malishevë dhe Kleçkë, pastaj në Prekaz, ndërsa gjatë ditës do të mbahet edhe një koncert në parkun e qytetit. Këtyre aktiviteteve do t'u paraprijnë edhe aktivitete të tjera sportive.

## Prokuroria në Gjilan brenda javës ka ndaluar nëntë persona të dyshuar

**GJILAN, 11 SHKURT (ER)** - Prokuroria Themelore në Gjilan gjatë javës së kaluar ka ndaluar nëntë persona të dyshuar, në kohëzgjatje prej 48 orëve, për vepra të ndryshme penale.

Departamenti i Përgjithshëm ka ndaluar pesë persona për shkak të dyshimit të veprave penale

"Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge", "Pengim i personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare", "Detyrim", "Vjedhje e rëndë", "Kanosje" dhe "Shtrengim" të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Departamenti i Krimeve të Rënda



ka ndaluar një person për shkak të dyshimit se ka kryer veprën penale "Keqpërdorim seksual i personave nën moshën 16-vjeçare" të KPRK-së.

Nga Departamenti për të Mitur janë ndaluar tre të mitur për shkak të dyshimit se kanë kryer veprat penale "Keqpërdorim seksual i

personave nën moshën 16-vjeçare", "Vrasje në tentativë" dhe "Lëndim i rëndë trupor" të KPRK-së.

Prokuroria Themelore në Gjilan, brenda afateve ligjore, për të gjitha këto raste ka paraqitur kërkesat për caktimin e masës së paraburgimit në Gjykatën Themelore në Gjilan.

# Shkodra e Shqipërisë dhe veriu i Kosovës, paralele historike

- Shkodra dhe rrethinat e saj në fillim të viti 1913 u pushtuan nga Mali i Zi, i cili shpresonte që, bazuar në Shën Stefan, i kishte ardhur koha ta aneksonte Shkodrën. Mirëpo, zhvillimet diplomatike në Londër e kundërshtuan aneksimin e Shkodrës dhe vendosën që Shkodra me rrethinat e saj të mbeteshin brenda territorit politik të Shqipërisë së pavarur.

- Qysh në ditët e fundit të luftës së vitit 1999 nisi de facto procesi i marginalizimit të veriut të Kosovës ose, më saktë, filloi procesi i mosbindjes së veriut të Kosovës, përfshirë Mitrovicën e Veriut dhe tri komunat serbe, Leposaviq, Zveçan dhe Zubin Potok ndaj pjesës tjetër të Kosovës, asokohe administruar nga UNMIK-u. Pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës në shkurt 2008, veriu i Kosovës, Mitrovica e Veriut dhe tri komunat serbe vazhduan ta injorojnë bindjen ndaj institucioneve sovraane e legjitime të shtetit të pavarur të Kosovës



Prof. Lisen BASHKURTI

Debati i nisur për ndarjen e veriut të Kosovës si pjesë e marrëveshjes përfundimtare për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë - Serbi tanimë vetëm sa ka shpërthyer në sipërfaqe. E themi këtë sepse, në të vërtetë, përpjekja për ndarjen e veriut nga Kosova ka nisur fillimisht de facto, qysh në përfundim të luftës në pranverë të 1999-s. Tani kjo tentativë e gjatë de facto po synohet të bëhet edhe de jure.

Inciesit e kësaj tentative vijnë pa pikë dyshimi nga Beogradi dhe Moskë. Është kryekëput në interesin e tyre shkëputja e veriut nga trunghi i integritetit territorial të Kosovës. Por, për arsye që dihen, promovimi i kësaj ideje cinguese për Kosovën nuk mund të lansohej publikisht as nga Beogradi e as nga Moskë për shkak të reaksionit të madh që do të shkaktonin tek shqiptarët në Kosovë dhe në mbarë rajonin si dhe te kundërshtarët e interesave serbo-ruse në Ballkan.

Pikërisht për mënjanimin e këtij reaksioni anti serbo-rus shqiptar dhe ndërkombehtar u gjetën dhe u nxitën promovues nga brenda hapësirave shqiptare: brenda Kosovës, zëdhënës i idesë për ndarjen e veriut të Kosovës u bë pikërisht presidenti Thaçi. Jashtë Kosovës, si hiena mbështetës së tij, u bënë disa zëra në politikën dhe diplomacinë e Tiranës. Midis Prishtinës dhe Beogradit ka edhe ndonjë zëdhënës mediatik ogurzi. Derisa Thaçi doli protagonist publik i vetmuar, i paqartë e kontradiktor dhe i kundërshtuar masivisht nga qytetarët, politika dhe institucionet e Kosovës, sikundër edhe nga fuqi perëndimore botërore, në Tiranë mbështetësit e Thaçit nuk kanë

dalë qartazi publikisht, por as nuk e kanë kundërshtuar atë asnjëherë. Kjo qasje hienash nga Tirana ka ngjallur dyshime të mëdha në Kosovë, në Shqipëri, ndër shqiptarë dhe në mjaft fuqi perëndimore.

## Mësimi i 'Shën Stefanit' ose Shqipëria e falimentuar

Pas luftës ruso-turke 1877-'78, në mars të vitit 1878 u firmos Traktati i Shën Stefanit dypalësh, i imponuar njëanshmërisht nga Rusia. Ky traktat synonte dhënien fund të kontrollit të Perandorisë Osmane mbi territoret e Ballkanit. Traktati njohu principatën e pavarur të Bullgarisë, njohjen e pavarësisë së Serbisë, Malit të Zi dhe Rumanisë. Bosnje Hercegovina u shpall autonome. Shqipëria dhe shqiptarët nuk u konsideruan. Traktati u kundërshtua nga Austro-Hungaria, e cila nuk e dëshironte nxitjen e nacionalizmave sllavo-jugorë dhe nga Britania e Madhe, e cila shikonte te shteti i madh bullgar rrezikun e një sateliti rus që mund të kërcënonte Stambollin dhe vetë ndikimin britanik në Mesdheun Lindor. Qëndrimeve Austro-Hungareze dhe Britanike iu bashkua diplomatikisht edhe Gjermania e Bismarkut në Kongresin e Berlinit, më 1878, duke bërë kështu modifikimin e termave të Traktatit të Shën Stefanit në fund të qershorit 1878.

Shqipëria dhe shqiptarët, ndonëse nuk u konsideruan si subjekt i pavarur dhe as autonom nga Traktati i Shën Stefanit, sërish për shkak të pretendimeve skajore mbi territoret shqiptare të fqinjëve grekë, serbë, malazezë e bullgarë si dhe të kundërshtive të disa Fuqive të Mëdha, kryesisht Austro-Hungaria e më pas edhe Italia dhe Gjermania, diplomacia ruse parashikoi një hapësirë bufferzonë për shqiptarët në Shqipërinë e Mesme.

Dizajnimi i hartës së Shën Stefanit për shqiptarët u ekspozua diplomatikisht pas shpalljes së

pavarësisë së Shqipërisë në Konferencën e Londrës në vitin 1913. Ishte një hartë sa një kuti shahu territor. Qëllimi rus ishte që nëse një shtet i pavarur shqiptar do të themelohej për shkaqe gjeopolitike, hapësira e tij territoriale do të duhej të ishte aq e kufizuar saqë të krijonte faktikisht një shtet tejet të dobët ekonomikisht. Një shtet i tillë në ballafaqimin e parë me fqinjët grekë apo sllavë të Jugut do të falimentonte.

Hartën e Shën Stefanit për Shqipërinë e pavarur e kundërshtuan fuqishëm dhe me argument Austro-Hungaria dhe Italia, të mbështetura në prapavijat diplomatike edhe nga Gjermania, relativisht edhe Britania. Franca asokohe luajti rol kryesisht negativ ndaj Shqipërisë dhe shqiptarëve. Në fokus të debatit për territoret e Shqipërisë së pavarur u bë Shkodra. Shkodra dhe rrethinat e saj në fillim të viti 1913 u pushtuan nga Mali i Zi, i cili shpresonte që, bazuar në Shën Stefan, i kishte ardhur koha ta aneksonte Shkodrën. Mirëpo, zhvillimet diplomatike në Londër e kundërshtuan aneksimin e Shkodrës dhe vendosën që Shkodra me rrethinat e saj të mbeteshin brenda territorit politik të Shqipërisë së pavarur.

Argumenti më i fortë për përfshirjen e Shkodrës dhe rrethinave të saj brenda kufijve politikë të shtetit shqiptar ishte viabiliteti i shtetit të ardhshëm shqiptar. Viabilitet do të thotë aftësia e brendshme e shtetit për të gjeneruar zhvillim ekonomik të qëndrueshëm për mbijetesë dhe zhvillim, bazuar në resurset e veta. Mbështetësit e kauzës së Shkodrës brenda kufijve politikë të Shqipërisë së pavarur argumentuan se pa Shkodrën dhe rrethinat e saj Shqipëria e pavarur do të humbiste rreth 25 për qind të PBB-së, sasi kjo që e bënte të pamundur mbijetesën ekonomike të brendshme të shtetit të pavarur. Argumenti u pranua ndërkombehtarisht. Shkodra dhe rrethinat e saj mbetën brenda shtetit shqiptar. Shqipëria mbijetoi.

## Kosova pa veriun, Kosovë e falimentuar

Qysh në ditët e fundit të luftës së vitit 1999 nisi de facto procesi i marginalizimit të veriut të Kosovës ose, më saktë, filloi procesi i mosbindjes së veriut të Kosovës, përfshirë Mitrovicën e Veriut dhe tri komunat serbe, Leposaviq, Zveçan dhe Zubin Potok ndaj pjesës tjetër të Kosovës, asokohe administruar nga UNMIK-u.

Pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës në shkurt 2008, veriu i Kosovës, Mitrovica e Veriut dhe tri komunat serbe vazhduan ta injorojnë bindjen ndaj institucioneve sovraane e legjitime të shtetit të pavarur të Kosovës. Liderët serbë në veri të Kosovës forcuan lidhjet direkte me Beogradin. Autoritetet e Kosovës nuk tentuan seriozisht asnjëherë që ta shtrin kontrollin e shtetit mbi gjithë territorin, ndonëse ishte e drejtë legjitime e patjetërsueshme e tyre që ta bënin këtë.

Kohë më pas pati zëra serbë në krye me Oliver Ivanoviçin, asokohe lider i Listës Serbe në Kosovë, që apeluan mbi Beogradin për një qëndrim më të moderuar lidhur me veriun e Kosovës dhe për një integrim gradual të tij në institucionet e Kosovës. Oliver Ivanoviç dhe UNMIK-u, krahas autoriteteve të Kosovës, folën hapur atëherë kundër mundësisë së ndarjes së Kosovës.

Por debatet në kohën e fundit lidhur me mundësinë e ndarjes së veriut të Kosovës duket se po përpiqen të ringjallin gjithë këtë histori. Oliver Ivanoviç u eliminua në prag të shpërthimit publik të këtij debati. Duket se Ivanoviç shikohej si pengesë e fortë nga pala serbe kundër ndarjes së veriut të Kosovës.

Shkaqet e shkakuar ende janë enigmë. UNMIK-u është në tërheqje, si në kompetencat e tij formale, po ashtu edhe praktikën e përditshme. Autoritetet e Kosovës janë me dy qasje: Presidenti Thaçi është promovuesi, madje edhe imponuesi i versionit të ndarjes së veriut të Kosovës, ndërsa Qeveria Haradinaj, parlamenti, partitë politike opozitare dhe opinioni publik e mediatik janë haptazi dhe agresivisht kundër presidentit Thaçi.

Presidenti i vetmuar Thaçi, duke u ndjerë përherë dhe më i izoluar në idenë e tij e, për rrjedhojë, edhe më i dështuar, po përpiqet të bëjë lojëra fjalësh si 'përcaktim', 'delimitim', 'demarkim', 'korrigjim', 'shkëmbim terriroresh', 'korrigjim të lehtë', 'përfshirje të Luginës së Preshevës në kufijtë e Kosovës' e të

tjera definicione që përkthehen të gjitha me fjalët: Ndarje e veriut të Kosovës.

Në këtë debat nga palët përdoren argumente që lidhen me historinë, kulturën, territorin, popullsinë, politikën, me institucionet, ndikimet gjeopolitike, Fuqitë e Mëdha, me pasuritë e Veriut të Kosovës etj. Por më duket se theksi kryesor duhet vënë mbi një pikë esenciale: Viabiliteti i shtetit të Kosovës pa veriun e saj.

Ashtu sikundër Shkodra për Shqipërinë e pavarur ishte ekzistenciale për aftësinë ekonomike për të gjeneruar mbijetesë dhe zhvillim të brendshëm të saj, po ashtu pikërisht edhe veriu për Kosovën e pavarur është ekzistencial për aftësinë ekonomike për të gjeneruar mbijetesë dhe zhvillim të brendshëm të saj.

Për kohëzgjatje Shkodra përbente potencialisht rreth 25 të PBB-së të mbarë Shqipërisë, edhe veriu i Kosovës përbën potencialisht, ndoshta akoma më shumë se 25 për qind të PBB-së të Kosovës. Por ndryshe nga struktura ekonomike dhe burimore e Shqipërisë, e cila është më e diversifikuar dhe më e shpërndarë, struktura ekonomike dhe burimore e Kosovës është më pak e diversifikuar dhe e lokalizuar kryesisht në veri.

Në Shqipëri burimet e naftës e të gazit, të kromit e të bakrit, të qymyreve e ujërave, të detit dhe Alpeve përbëjnë burimet shumë diverse ekonomike dhe janë të shtrira në mbarë territorin e vendit. Në Kosovë burimet minerare dhe ujërat janë kryesisht në veri të Kosovës, ndërkohë që pjesa tjetër ka kryesisht qymyre të varfra dhe bujqësi e blegtori. Pra, pa veriun Kosova rrezikon seriozisht të shndërrohet në një fermë bujqësore e blegtorale, pra pa aftësi për të gjeneruar mundësi ekonomike mbijetese dhe zhvillimi të brendshëm.

Një shtet pa viabilitet, pra pa aftësi për të gjeneruar aftësi ekonomike të brendshme për mbijetesë dhe zhvillim të pavarur, do të thotë një shtet pa perspektivë ekonomike, një hapësirë e varfër e më së shumti një i shtet i falimentuar ekonomikisht. Një shtet i falimentuar ekonomikisht, në ballafaqimin me krizën më të parë fqinjësore, rajonale apo ndërkombehtarë, do të kapitullonte pa kushte. Ja përse viabiliteti është një ndër kushtet e pavarësisë dhe sovranitetit të shtetit. Ja përse edhe Kosova pa veriun e saj humbet edhe ekzistencën si shtet i pavarur dhe sovran. Viabiliteti është gur themeli për ekzistencën dhe funksionimin e shtetit të Kosovës.

# Dritë diellore, rrugëtim shekullor dhe jetësor për liri

## Shkelqim MILLAKU

Libri "Skënderbeu dhe porositë për shekullin XXI", Prishtinë, 2018, nga autori Jakup Krasniqi, ofron studime, mendime dhe shkrime krahasuese që janë mjaft interesante për simbolin e bashkimit të shqiptarëve, të cilin simbol kombëtar, me emrin Skënderbe, e kemi të njohur kombëtarisht dhe ndërkombëtarisht për 550 vjet. Simbol i rezistencës arbërore dhe i frymëzimit brez pas brezi për liri dhe çlirim.

Lexuesi i thelluar në shkencë dhe ai informativ në kohë mund ta kuptojnë që në fillim se bëhet fjalë për Skënderbeun, por autori në këtë monografi historike, bashkon shtyllat thelbësore: lindjen, zhvillimin dhe vdekjen e Skënderbeut, por në veçanti ndërton lidhshmërinë e konceptit të rezistencës çlirimtare nga Skënderbeu dhe deri të Adem Jashari. Kjo lidhje kronologjike nuk është e lehtë të mendohet, të përshkruhet dhe argumentohet as për Marin Barletin në atë kohë dhe as për Jakup Krasniqin në këtë kohë. Ky i fundit me një gjuhë dhe shkrim të shkathët ka arritur ta informon lexuesin dhe studiuesin se besëlidhja shqiptare, por edhe krahasimet kronologjike si nga autorët vendor, po ashtu edhe të huaj e kanë brumëzuar vlerën e librit të autorit në fjalë.

Autori, librin e ndan në disa kapituj, të cilët, për personazh kryesor kanë Skënderbeun ndryshe. Skënderbeun besëlidhës. Skënderbeun çlirues të Arbërisë. Skënderbeun frymëzues shekullor për liri. Skënderbeun e studiuar nga vendoret dhe ndërkombëtares. Skënderbeu dhe porosia e tij deri të Adem Jashari. Skënder - Adem. Për këtë fundit, autori e lidhë dhe forcon peshën e rrugëtimit për liri. Thellësia e lidhshmërisë së mendimeve historike, akademike dhe diplomatik e fuqizon peshën e librit dhe si e tillë ka zë vend të botohet nga një institut serioz, siç është Instituti i Historisë në Prishtinë.

Autori në vend të hyrjes ka dy studime të thukëta dhe mesazhdhënës. Në studimin e parë, e kemi kumtesë interesante që simbolizon dhe krahason "dritën diellore -

rrugëtimit shekullor dhe jetësor për liri".

Autori në këtë studim citon kontributdhënësit e kohës së Skënderbeut, të cilët kanë lënë gjurmët e tyre, si në shkrimet e periudhës së humanizmit dhe të iluminizmit, po ashtu edhe në shkrimet studimore të ndryshme. Krahasimi dhe mesazhi i Frang Bardhit, Marin Barletit dhe i Besëlidhjes së Lezhës, e cila është mbajtur, më 2 mars 1444 e fuqizojnë kumtesën në fjalë. Përveç autorëve vendor, kumtesën e fuqizojnë edhe mendimet e autorëve të

njerëzi me energji diellore gjashtëshekullore që vjen nga Gjergj Kastrioti Skënderbeu ynë i Madh".

Nga kjo që është thënë që në kumtesën e parë, ende pa hyrë në kapitullin e parë, autori paralajmëron lexuesin se kemi një monografi serioze për ta lexuar dhe informuar për lidhshmërinë e asaj që quhet simbolikë diellore.

Kumtesa e dytë fillon me citimin e danezitet Ludvig Holberg, i cili thotë: "Mund të thuhet për këtë burrë, se ai ishte heroi me i madh në histori, dhe askush, as në historinë e vjetër dhe as në atë të re, nuk mund të krahasohet me të".

Dihet fakti se ka shumë autorë vendor dhe ndërkombëtar që kanë hulumtuar dhe folur për Skënderbeun, por në libri "Skënderbeu dhe porositë për shekullin XXI" gjejmë mjaft argumente frymëzuese për atë që quhet "çelësi i suksesit përmbajtësor - rrugëtim i lirisë - çlirimi".

Autori e ka konsideruar të arsyeshme për ta studiuar, analizuar dhe krahasuar në disa kapituj.

Në kapitullin e parë kemi: Fjala e Skënderbeut para kapedanëve dhe ushtarëve kryetrima të Arbërisë.

Në kapitullin e dytë është: Fjala e Skënderbeut para fisnikëve në Lezhë 2 mars 1444.

Në kapitullin e tretë: Gjergj Kastrioti Skënderbeu nëpër shekuj (1405-2018).

Kapitulli i katër: Porosia e fundit e Gjergj Kastriotit Skënderbeut.

Kapitulli i pestë: Fjala e fundit e Skënderbeut sipas Marin Barletit.

Libri vazhdon me artikuj për Skënderbeun, të cilat e brumëzojnë dhe kompletojnë mendimin.

Shkrimet krahasuese për Skënderbeun dhe Adem Jasharit e kompletojnë lidhshmërinë kronologjike që nga viti 1405 dhe deri të publikimi i librit në fjalë.

Lexuesi kur do t'i lexon shkrimet dhe burimet referuese që i ka libri, pra monografia, atëherë do ta kupton rolin përmbajtësor dhe mesazhdhënës që e ka kjo monografi shkencore.

Mendimet e autorit të prezantuara në këtë libër janë përmbledhje idesh nga kontributi i tij jetësor si: intelektual, pedagog, diplomat, veprimtar nga fusha politiko-ushtarake etj. Ky është libri i katërbëdhjetë i tij, dhe shumë nga këto libra dhe mendime janë të shpërndara në bibliotekat kombëtare dhe ato ndërkombëtare në Evropë e më gjerë.



FAHREDIN SHEHU

## DURIMI

Pashë shumë besimtarë në stacion treni ata që më shumë i besojnë itinerarit të kompanisë sesa ata që në kisha dhe xhamia i luten Zotit t'ua sjellë një biçikletë për çunin parashkollor dhe ata të cilët i besojnë vetes më shumë se hijes që s'u ndahet as atëherë kur nata erret e dita mbushet grindje

## KRENARIA

Pështjellur me renë e krenarisë nxora një bankënotë në dorë ia lëshova lypsarit bora kishte mbuluar acarin akullin nën këmbët e mia aromë gështenjash të pjekura në shesh vinte rrëshqita dhe rashë pa thyer gjymtyrë e prisja këtë shpërblim për mirësinë e bërë mendja kujtonte se kishte dhënë dora e majtë

## PËRBUZJA

Kur i përbuzuri shumëvjeçar parakalon në oborrin e universitetit në ditën e dhjetë të javës vëren në skaj të bankës së parkut i heshtur plaku bën sehir nuk është lypsar as lexon gazeta e loz shah pensionistësh vetëm vështron sytë e studentëve mos vallë do të gjejë ndonjë pasqyrë të pathyer një i ri iu afrua me një torbë përplot libra dhe një zemër të tillë desh e ndau përgjysmë një sandviç tune plaku buzëqeshi dhe e përkëdheli

## MODESTIA

Veshur me petka më të reja dhe zemra të njoma me hir si njomet fyti i lutësit në orët e vona të natës vashat nuk shikojnë vërdallë as dorë as fytyrë e as sy shejtani kokulur parfumojnë flokët e nënave shtatzëna - krenare se në këtë botë do të sjellin engjëj të ri me shpresën se nuk do të djallëzohen në të përquar u turpëruam si nuk gjetëm pak buzëqeshje edhe për ta

## FISNIKËRIA

Në gjakun e kuq ku burri dhe gruaja dhe fëmijë të lindur të pastër nga njollat e së ligës dhe nga vragët që ato lënë pas kush fal është i fortë kush harron të ligën jeton në paqe thoshte gjermani i urtë

# Një dokument i rëndësishëm për likuidimin e Mulla Idriz Gjilanit (2)



Prof. dr. Sabile  
KEÇMEZI-BASHA

Pas sulmit në Gjilan, që u bë pa pëlqimin e Mulla Idrizit, ai strehohet në fshatin Tugjec, e pastaj te familja patriotike Sadiku në Gjyrishec. Aty qëndroi pesë vjet me popullin dhe në kontakt të përhershëm me Lëvizjen e Rezistencës. Një ditë, pas shumë kërkimesh, zbulohet dhe arrestohet (sipas dokumentit me nr. 887, 49), në natën e 26 nëntorit 1949. Lajmi për arrestimin e Mulla Idrizit u përhap me shpejtësi. Pas pesë ditësh, më 2 dhjetor familjes ia kumtojnë lajmin për vdekjen e Mulla Idrizit. Gjatë kohës së kaluar në hetuesi Mulla Idrizi përjetoj torturat më të tmerrshme, por s'u dorëzua. Trupin e tij, pas mesnatës së datës 2 dhjetor 1949, e nxjerrin nga burgu dhe e dërgojnë në periferi të Gjilanit, në vendin e quajtur "Gllamë", ku e varrosin. Ishte krejt normale që pushtetarët e hetuan një rrezatim të patriotit të shquar dhe ndien rrezikun nga ai. Shpejtuan ta asgjësonin Mulla Idriz Gjilanin sepse ai asnjëherë nuk dëshoi të bie në duart e tyre të pista, të bashkëpunonte me ta, të shpifte, t'i jepte shokët, të tjetërsohej dhe asnjëherë nuk pranoi ta mohonte veten.

Në vazhdim do ta prezantoj dokumentin e plotë të Ministrisë së Punëve të Brendshme të RFPJ-së për rrethin e Gjilanit, ashtu siç e ka lëshuar Arkivi Regional i Gjilanit. Dokumenti është i lëshuar më 3 dhjetor të vitit 1949 dhe mban numrin 887, Gjilan.

"Propozimi për ndërprerjen e hetimit penal, në burgun hetues (respektivisht i burgosur), kundër Mulla Idriz Hajrullahut - hoxhë nga Gjilani".

Në dokument nuk shkruan fare se kur është arrestuar dhe kur ka përfunduar burgun. Në vazhdim thuhej se është hapur hetuesia penale me burgim hetues (është caktuar burgimi) me vendimin e Prokurorit Publik të Rrethit të Gjilanit, me vendim të lëshuar më 26 nëntor 1949, çka dëshmohej se Mulla Idrizi është arrestuar më 26 nëntor dhe dokumenti mban po këtë datë (26 nëntor), me nr. 18/49, me dyshimin se ka kryer vepër penale, sipas nenit 3, pika 3 dhe 8, të Ligjit penal të RFPJ-së. Pasi gjatë hetuesisë, respektivisht më 2 dhjetor 1949 ka bërë vetëvrasje në burg, andaj propozojmë të ndërpritet burgu

hetues dhe hetuesia e mëtejshme.

Pasi gjatë hetuesisë nuk është vërtetuar se ka kryer vepër penale (të përmendën arsyet të parapara me nenin 112 të Ligjit penal) andaj propozojmë që të ndërpritet hetuesia penale dhe të hiqet burgimi i hetuesisë (respektivisht burgimi). Por e thashë edhe më lartë, se Mulla Idrizi nuk ka pranuar asgjë nga akuzat që i kanë bërë udbashët, nuk ka bashkëpunuar me ta dhe nuk ka treguar emra personash që kanë bashkëpunuar me të, andaj të gjitha pyetjet e tyre kanë ngelur pa përgjigje. Dhe kjo i ka egërsuar tej mase.

Sipas dokumentit, thuhej se për këtë ndërprerje të hetuesisë u dashka ta shtojnë edhe shtojcën nga të dhënat e hetuesisë.

Krejt këtë material e kishte nënshkruar organi i autorizuar, Dragi Popoviqi.



Në vazhdim po e japim procesverbalin të punuar më 2 dhjetor 1949 në zyrat e autorizuar të UDB-së në Gjilan. Në hulumtimet e bëra nga ana e organit hetues, togerit Dragutin Popoviqi, i autorizuar i UDB-së në Gjilan, më 2 dhjetor 1949 në vendin e ngjarjes ku është tentuar për të bërë vetëvrasje nga ana e Mulla Idriz Hajrullahut nga Gjilani.

Pasi është kryer hulumtimi në vendin e ngjarjes, është vërtetuar se: Në ditën e 2 dhjetorit 1949 në orën 2.50 minuta ka ardhur tek unë në banesë oficeri kujdestar i autorizuar, Gjorgje Budimiri, dhe më ka lajmëruar se i burgosuri, ish i arratisuri Mulla Idriz Hajrullahu nga Gjilani, i cili ndodhej në qeli, ka tentuar të bëjë vetëvrasje në mënyrën që ka ndezur rrobat e trupit dhe në atë mënyrë ka tentuar që ta nxisë vdekjen. Pas kësaj, mbi të janë marrë masat menjëherë për lidhjen e plagëve nga ana e infermierëve të spitalit të këtushëm - Memta H., i cili ka thënë se nuk ka rrezik për jetë.

Pastaj kam ardhur në vendin e ngjarjes dhe në rend të parë kam bërë shikimin e situatës, me të cilën kam konstatuar se plaga

është e rëndë. E kam pyetur se për çfarë ka tentuar diçka të tillë. Më është përgjigjur se: "Kam pasur punë me dreqin". Në dhomën ku ka qëndruar kishin mbetur pjesë të trobave të djegura. Në pyetjen time se si është djegur, më është përgjigjur se e kishte bërë me anën e një qibruti që e kishte te vetja për hir të duhanit që pinte, se thoshte ai, se tjetër mundësi nuk kisha dhe se vetëm në këtë mënyrë kam mundur ta bëja. Pastaj kam filluar ta marr në pyetje policin kujdestar i cili i pari kishte ndie erën e djegies - Elez Bislimi, i cili deklaroi sa vijon: "Në ditën e 2 dhjetorit, rreth orës 2 e 30, e kam ndier se si dikush po ngulfatet dhe britmë në qelinë në të cilën ndodhej i burgosuni Mulla Idrizi. Menjëherë e kam thirrur oficerin kujdestar Gjorgje Budimirin dhe bashkërisht e kemi hapur derën e qelisë. Kemi parë se si brenda

kishte shumë tym, ndërsa ai rënkonte, e shihnim flakën në trupin e tij dhe menjëherë e kemi nxjerrë jashtë në korridor, i kemi hedhë ujë dhe zjarri është shuar. E pamë se kishte lëndime në trup dhe menjëherë ju kemi thirrur juve. Pas një kohe të shkurtër ka ardhur infermieri, i cili i dha ndihmën e parë dhe e lidhi me fasha. Po gjatë kohës së tentimit për vetëvrasje, para se të ndodhte kjo, i burgosuri Idrizi ka lidhur kyçet e këmbëve që gjatë rrotullimit këmbët të mos luhaten, gjithashtu vrimën në derë e kishte mbyllur me lecka që tymi mos të dal në korridor. Jorganin të cilin e kishte në dhomë e kishte larguar në një qoshe të saj, ndërsa ai ishte kallë në qosën tjetër të saj".

Gjatë ditës në përgjithësi ka qenë në gjendje të keqe, ndërsa në orën 13:30 minuta ka dhënë shpirt. Pas dy orëve mjeku Aleksandar Gjekiq, në praninë e prokurorit të rrethit Tahir Ibrani dhe organit autoritar, kanë konstatuar se ka pasur vdekje.

## Hetuesin e bëri togeri

"Dragutin Popoviqi (është nënshkrimi i tij)", përfundon

dokumentin.

Të bëjmë një analizë të thjeshtë se si hetuesi apo udbashi i njohur i Anamoravës, Dragi Popoviqi, bie në kundërshtim me të dhënat e veta.

1. Mulla Idrizi ishte në qeli dhe mirë dihej se sa mundet me qenë e madhe qelia- ajo ishte thjeshtë një birucë ku qëndronin të burgosurit, dhe nuk besoi se ka pasur aso privilegje Mulla Idrizi, sa të vihen në dispozicionin e tij jorganët e çarçafët e bardhë, kur dihej se të burgosurit kanë vdekur edhe nga i ftohti në qelit e burgut. Shumë prej tyre janë sëmur nga tifoja e morrit, dhe shpesh gjymtyrët e trupit iu kanë hëngër minjtë (pacovat);

2. Pastaj nuk besoj se një kalibër i tillë i të burgosurit siç ishte Mulla Idrizi, do e linin pa roje tek dera, kur dihej se pushtetarët nga ai tmerrheshin. Po ky, ishte që mbi pesë vite nuk kishin mundur ta zbulonin vendin e tij të strehimit dhe po ashtu e dinin se sa e adhuronte populli dhe nuk ishte larg mendjeje që të organizoheshin popullata dhe të sulmonte burgun ku ndodhej hoxha;

3. Të mendojmë vetëm një çik, athua vërtet, hoxha do iu kishte përgjigjur pyetjes së hetuesit, se ai "kishte pasur punë me dreqin", dhe çfarë donte të thoshte me këtë hetuesi. Në një mënyrë donte ta deklasonte hoxhën si fetar dhe tjetrën donte të paraqiste atë, se ai ishte penduar për veprimtarin që kishte zhvilluar. Por, populli asnjëherë nuk e kollofti aq lehtë të dhënë e falsifikuar të hetuesve në burgun e Gjilanit;

4. Hetuesi thotë se Mulla Idrizi u vetëkallë me qibrutin e vet që e përdorte për të pirë duhan, ndërsa e vërteta është krejt tjetër, nga se familjaret të cilët e strehuan hoxhën në Gjyrishec, dëshmojnë se hoxha kurrë, ama bash kurrë,


nuk e kishte tymosur duhanin. Andaj edhe kjo ishte gënjeshtër e radhës;

5. Ajo që është, edhe më e rëndësishmja, është se me fenë islame repretësisht është e ndaluar që njeriu duhet të bëjë vetëvrasje, ngase thuhej se "zoti të falë jetën dhe vetëm zoti mund të ta marrë atë". Çfarë gënjeshtre të kulluar shkruajnë udbashët për vetëkallje të atdhetarit Mulla Idriz -Gjilanit;

Pra, duke e lexuar dokumentin, pa dashur të kapë frika, athua vallë sa e sa falsifikimet janë bërë në dokumentet ndaj shqiptarëve të cilat përdorën pa ditë se prapaskenat e tyre ishin skandaloze e të tmerrshme.

Dhe krejt në fund, dokumenti i zbuluar, megjithatë, është një lajm i mirë që na ofron një të dhënë të rëndësishme historiografike për kohën e arrestimit dhe, gjithashtu, edhe për vdekjen e tij, ngaqë ekziston një e dhënë sado e falsifikuar të jetë, por besoi se dita e arrestimit dhe e djegies së Mulla Idrizit duhet të jenë të sakta, ngaqë këto data nuk kanë pasur ndonjë rëndësi historike. Ndërsa për mua si historiane dhe që jam ballafaquar goxha shumë me dokumente "top sekret", nuk besoi dhe se jam shumë e bindur në falsifikimin e të dhënave për "vetë djegjen" e Mulla Idrizit, ngaqë monstruoziteti dhe falsifikimi i udbashve ka qenë dhe vazhdon të jetë specialitet i tyre. Megjithatë, besoi, se sido që të jetë, ky dokument do të ketë rëndësinë e vet për opinionin e gjerë, në veçanti nga komuniteti i historianëve, ngase jeta e vepra e Mulla Idrizit do të jetë më e plotësuar dhe është e lidhur ngushtë me ndriçimin e historisë së Lëvizjes Kombëtare Shqiptare dhe të popullit të saj në Kosovë e më gjerë.

Lavdi Mulla Idriz Gjilanit!



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri

Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE**  
"BUJQËSIA"  
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

MAN UTD - PSG

1

ROMA - PORTO

1,3+

FENERBAHÇE - ZENIT

||&gt;|

## Gjyqtarët e Kosovës, pjesë e Konventës së Gjyqtarëve të UEFA-s

Gjyqtarët e Kosovës janë anëtarësuar në Konventën e Gjyqtarëve të UEFA-s, kurse instruktori Alan Snoddy, që vlerësohet më meritori për këtë sukses, ka thënë se gjyqtarët e Kosovës do ta kenë përkrahjen e UEFA-s edhe në të ardhmen. "Ne emër të UEFA-s ju them se do të vazhdojmë t'ju monitorojmë dhe t'ju përkrahim. Për mua është një ndjenjë e veçantë ta përcjellësh Kosovën për dy vjet e gjysmë dhe ta shohësh duke u anëtarësuar në Konventën e Gjyqtarëve të UEFA-s", ka thënë Snoddy



Gjyqtarëve të UEFA-s", ka thënë Snoddy, i cili ka vlerësuar se ndarja e drejtësisë nuk është punë e lehtë. "Është e pamundur të jesh i përkryer në çdo aspekt të lojës dhe në çdo ndeshje. Në çdo ndeshje lojtarët bëjnë gabime, trajnerët bëjnë gabime dhe, normalisht, gjyqtarët bëjnë gabime. Gjyqtarët nuk janë robotë, nuk mund të jenë gjithmonë të saktë, por sfida është që ne të synojmë t'i minimizojmë gabimet", ka shtuar ai.

Për anëtarësim në Konventën e Gjyqtarëve të UEFA-s, kryetari i Komisionit të Gjyqtarëve të Kosovës, Përparim Hasani, meritorë i ka bërë ish-kryetarin e FFK-së, Fadil Vokrri, kryetarin aktual, Agim Ademi, sekretarin e përgjithshëm të Federatës së Futbollit, Eroll Salihun, instruktorin e UEFA-s, Alan Snoddyt.

EPOKA E

Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 11 SHKURT** - Gjyqtarët e futbollit të Kosovës tash e tutje do të jenë të barabartë me gjyqtarët e vendeve të tjera, pasi janë anëtarësuar në Konventën e Gjyqtarëve të UEFA-s. Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, pasi foli për rëndësinë e këtij anëtarësimi, duke thënë se me meritori për një gjë të tillë është instruktori i UEFA-s, Alan Snoddy. Me këtë rast numri një i futbollit të Kosovës konfirmoi se Snoddy do të vazhdojë të jetë pjesë e futbollit të Kosovës, përkatësisht "krah" i gjyqtarëve.

"Për këtë anëtarësim e falënderoj mikun tonë, Alan Snoddy, i cili ka punuar vazhdimisht me ne dhe është më meritori për këtë sukses. Ai i ka përgatitur gjithë ekipin dhe gjyqtarët si në anën teorike, po ashtu edhe në atë fizike, por na ka ndihmuar edhe për përgatitjen e gjithë dokumentacionit të nevojshëm për pranim në Konventën e Gjyqtarëve të UEFA-s. Alani do të vazhdojë të jetë gjatë me ne, sepse ende kemi nevojë për ndihmën e tij", ka thënë Ademi në konferencën për medie, ku i pranishëm ishte edhe instruktori i UEFA-s, Alan Snoddy.

Ky i fundit ka vlerësuar se, po të

ishite gjallë legjenda e futbollit të Kosovës, Fadil Vokrri, do të ishte shumë krenar, por ai ka lavdëruar edhe punën e Agim Ademit dhe Eroll Salihut. "Pas më shumë se dy vjetëve punë të vazhdueshme ka ardhur edhe shpëtimi, duke u anëtarësuar në Konventë. Anëtarësimi ofron mundësinë për mbështetje financiare për projektet zhvillimore dhe ngritjes profesionale të gjyqtarëve, por edhe të vëzhguesve dhe instruktorëve. Në emër të UEFA-s ju them se do të vazhdojmë t'ju monitorojmë

dhe t'ju përkrahim. Për mua është një ndjenjë e veçantë ta përcjellësh Kosovën për dy vjet e gjysmë dhe ta shohësh duke u anëtarësuar në Konventën e

### TË PREMTEN RIKTHEHET SUPERLIGA

Ndeshja në mes të KEK-ut dhe Llapit, e cila do të zhvillohet nga ora 13:30 në stadiumin "Agron Rama" në Obiliq, do ta hapë stinorin pranveror në IPKO Superligë. Dy ndeshje do të luhen të shtunën: Ballkani - Drenica dhe Ferizaj - Trepça '89, kurse të dielën zhvillohet derbi Drita-Gjilani. Java e 18 do të mbyllet me dy ndeshje që zhvillohen të hënën, e ku takohen Flamurtari - Prishtina dhe Liria - Feronikeli.

## Mulaomeroviqi publikon listën anti-Rumani



**PRISHTINË, 11 SHKURT** - Përzgjedhësi i Kosovës, Damir Mulaomeroviqi, e ka publikuar listën e gjerë të Përfaqësueses A, e cila më 24 shkurt do të përballet me Rumaninë në kuadër të Grupit B të parakualifikimeve për "Eurobasket 2021". Përfaqësuesja do të grumbullohet

#### LISTA E BASKETBOLLISTËVE

Dardan Berisha, Lis Shoshi, Leonard Mekaj, Valon Bunjaku, Malcolm Armstead, Mikailë Tmusiq, Meriton Ismaili, Arian Qallaku, Erjon Kastrati, Edmond Azemi, Samir Zekiqi, Rron Crapci, Drilon Hajrizi, Besnik Azemi, Fisnik Rugova.

më 18 shkurt në Prishtinë për ndeshjen kundër Rumanisë, që i takon parakualifikimeve për "Eurobasket 2021". Dueli Kosovë - Rumania do të zhvillohet më 24 shkurt 2019, me fillim nga ora 20:30, në Pallatin e Rinisë dhe Sporteve në Prishtinë. Kosova bën gara në Grupin B dhe në tri duet e para ka pësuar disfatë, dy herë nga Maqedonia dhe një herë nga Rumania, ndërsa e ka edhe një shans në muajin gusht për ta siguruar një vend për në kualifikime për "Eurobasket 2021". Pra, Maqedonia i prin grupit me 6 pikë, ku nga tri

ndeshje ka po aq fitore, kurse Rumania dhe Kosova i kanë nga tri pikë secila, përderisa rumunët i kanë luajtur dy ndeshje deri më tani dhe dy të tjerat do t'i luajnë në muajin shkurt, së pari kundër Maqedonisë, më pas kundër Kosovës. Fituesi i grupit do ta sigurojë një vend direkt për në kualifikime për "Eurobasket 2021". Raundi shtesë i parakualifikimeve për "Eurobasket 2021" do të zhvillohet prej 3 deri më 21 gusht, ndërsa emrat e kundërshtarëve Kosova do t'i mësojë në shkurt, pas ndeshjes kundër Rumanisë.

## Eliminimi nga Kupa ia 'ha' kokën Shpëtim Duros

**GJILAN, 11 SHKURT** - Skuadra e Dritës nga Gjilani ka njoftuar se trajneri Shpëtim Duro ka dhënë dorëheqje pas eliminimit nga gara e Kupës. "Pas një takimi që kishim menjëherë pas ndeshjes

së djeshme, me një marrëveshje mes dy palësh është vendosur që të ndërpritet bashkëpunimi. Pas eliminimit nga Kupa e Kosovës dhe daljes nga objektivi i vetëm i klubit për këtë sezon,

Duro ka ofruar dorëheqje, që është pranuar nga klubi bardhekalër. FC Drita e falënderon profesor Duron për punën profesionale që ka bërë me klubin dhe i dëshiron shumë suksese",

thuhet në njoftimin e skuadrës nga Gjilani. Drita, që është kampione aktuale e Superligës, përveç eliminimit nga Kupa, është edhe jashtë garës për titull të kampionit.



## Neueri, tifozëve: Luaj ndaj Liverpoolit

MUNCHEN, 11 SHKURT - Një dëmtim në dorë bëri që Manuel Neuer të mos ishte i pranishëm në tri ndeshjet e fundit të Bayern Munchenit. Megjithatë, tifozët "bavarezë" s' duhet të shqetësohen pasi "gardiani" gjerman është i bindur se do të riaftësohet në

